
BULETIN INFORMATIV

Gusht 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Gusht, 2024

Përmbajtje

Projektet e Albanologjisë / Enciklopedia shqiptare.....	6
"Enciklopedia shqiptare": redaksitë e grup-fushës së arkeologjisë, religjionit dhe arkitekturët diskutojnë dhe vendosin për njësitë enciklopedike të pikëtakimit të objektit të tyre.....	7
Redaksitë e tri fushave: letërsi, arte dhe komunikim, krahasojnë listat e njësive enciklopedike të propozuara prej tyre dhe marrin vendime për përkatësinë e atyre të përbashkëta	9
Takime të redaksive të "Enciklopedisë shqiptare" sipas ndarjes në grupfusha.....	12
Redaksia e bujqësisë dhe redaksia e mjedisit sot në takim pune për të diskutuar e vendosur për lëndën enciklopedike në pikëtakim mes tyre	16
Promovime.....	20
Jo vetëm në nanoshkencë e albanologji, por edhe në studimet shoqërore	21
Aktivitete.....	23
Seminari i 42-të ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, që organizohet në gusht nga Universiteti i Prishtinës, vjen sivjet bashkë me 50-vjetorin e themelimit të tij nga UP	24
Seminari i 42-të ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.....	28
Të tjera.....	36
"How to think about the instrumental politics of mass rape: a critical appraisal of feminist approaches"	37
Përfaqësim cilësor i letërsisë shqipe sot në shtypin letrar kroat.....	39
Akad. Rexhep Meidani shkruan për Hasan Tahsinin, matematikan shqiptar, filozof e astronom, rektor i parë i Universitetit të Stambollit.....	41
Interesim mbarëshqiptar për Vitin Kombëtar të Gjuhës dhe konferencën shkencore ndërkombëtare në Ditën e Gjuhës Shqipe, në përvjetorin e Kongresit të Manastirit.....	42
Banka Botërore, në raportin e saj të posabotuar, vlerëson si një prej arritjeve të Shqipërisë për përfshirjen në bashkëpunim me diasporës intelektuale themelimin e qendrës “NanoAlb”	45
"NanoAlb", the Regional Centre of Nanoscience and Nanotechnology next to the Academy of Sciences of Albania.....	47
“Bindni emigrantët që të rikthehen!”	53

Në raportin e Bankës Botërore pozitivisht vlerësohet fakti që në vitin 2019 Akademia e Shkencave krijoi njësinë "NanoAlb", një qendër virtuale për të koordinuar kërkimet e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë.....	55
Botohet në vijim dokumenti bazë në të cilin u mbështet vlerësimi i Bankës Botërore për njësinë “NanoAlb” të ngritur pranë Akademisë së Shkencave si një model bashkëpunimi me diasporën intelektuale shqiptare	57
Profesor Albert Hafner, bashkëdrejtues i ekspeditës arkeologjike shqiptaro-zvicerane në vendbanimin palafit neolitik të Linit, flet për "News 24 TV"	65
Më 19 gusht 2024 do të çelet në Muzeun "Marubi" ekspozita "Vëllezërit Kodheli dhe Kolë Idromeno - Rilindja në artin pamor shqiptar" e kuruar nga Luçjan Bedeni	67
Çmimi "Olcinium" i panairit veror të librit, që organizohet në Ulqin, për studimin monografik iu dha librit "Baladë dritash për Zef Zorbën" të Viola Isufajt, botim i Akademisë së Shkencave (2023)	70
Sot ditëlindja jubilarë e akademikut Rexhep Meidani	73
Gjuha shqipe është krejt origjinale dhe e dallueshme midis gjuhëve të tjera të familjes që i takon, sepse është monogjuhë: "Nuk kemi gjetur një gjuhë indoeuropiane më të dallueshme se gjuha shqipe"	75
"Një vështrim krahasimtar letërsisë sociale në Ballkan në periudhën mes dy luftërave", ligjëratë nga Shaban Sinani	78
Dorëshkrimet e shkrimtarit Ismail Kadare do të ruhen në një mjedis të veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA)	83
Matteo Mandalà dhe Lea Ypi, anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave, referues për diplomacinë kulturore në konferencën "Diplo 2024" organizuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	87
Botime të reja	90
Albert Nikolla boton librin "Antikultura" e 1968-ës në Shqipëri"	91
"Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon"	93
In memoriam	94
Gjergj Gjura, një nga përfaqësuesit e brezit të parë të ekspertëve shqiptarë të matematikës së zbatuar, është ndarë nga jeta	95
Sot ditëlindja e bashkëthemeluesit të Akademisë së Shkencave, ikonës së saj të djeshme e të sotme, historianit të gjuhës, letërsisë dhe trashëgimisë gojore, prof. Eqrem Çabej.....	97
Dhjetë vjet nga ndarja nga jeta, nderim akad. Shaban Demirajt.....	98
Homazh për Luan Starovën, shkrimtar i tri gjuhëve, në televizionin francez "Arte"	100

Nekrologji	103
Ndahet nga jeta studiuesi i njohur Mevlan Kabo	104
U nda nga jeta "mbrojtësi i gjuhës së etërve", hartuesi i ligjit për statusin juridik të gjuhëve të pakicave në Itali, propozuesi e realizuesi i njohjes ligjore të arbërishtes si gjuhë mësimi në shkollë, on. Mario Brunetti	106

Projektet e Albanologjisë / Enciklopedia shqiptare

"Enciklopedia shqiptare": redaksitë e grup-fushës së arkeologjisë, religjionit dhe arkitekturës diskutojnë dhe vendosin për njësitë enciklopedike të pikëtakimit të objektit të tyre



- I nevojshëm zgjerimi i diskutimit me redaksinë e gjeografisë sociale (për qytetet dhe emërtime të tjera të antikitetit, krishterimit të hershëm dhe mesjetës); të historisë, gjuhësisë (për shpjegime të nevojshme etimologjike) dhe të antropologjisë -

- Fryma e enciklopedizmit dikton që njësia të ketë një fushë-bazë, por duke pasur bashkëpunimin e specialistëve të disiplinave të afërme -

Të pranishëm në takim akademikët Gëzim Hoxha e Adem Bunguri (arkeologji), prof. asoc. dr. Albert Nikolla (religjion), dr. Arian Leka (QBEA) dhe Shaban Sinani nga redaksia vendore.

Në dy seanca pune, më 29 dhe 31 korrik 2024 drejtuesit e këtyre redaksive dhe koordinatorët e caktuar nga redaksia vendore dhe QBEA shqyrtuan listat e fjalësve të përbashkët dhe vazhduan përzgjedhjen, duke vlerësuar se grupimi i disa njësive enciklopedike jodomethënëse tek termi bazë (institucioni ku ka ushtruar veprimtarinë, didiplina ku është dalluar, hierarkia ku ka bërë emër) është zgjidhja më e arsyeshme.

Përzgjedhja mund të vijojë edhe duke bashkuar emërtimin e përveçëm me atë të nocionit themelor (titullarët tek subjekti apo enti, ofiqarët në religjione tek termi i hierarkisë).

Po ashtu, grupimi mbi bazën e drejtimit të përbashkët në prirje e interesa mundëson përfaqësimin e gjerë të personaliteteve pa rënduar numerikisht regjistrin themeltar të fushës dhe të "Enciklopedisë" në tërësi (orientalistët, si grupim studiuesish;

frymëzuesit në besim për figura të shquara klerikësh ose personash historikë që përthirren në besim).

Mundësi për një përzgjedhje më cilësore jep edhe shqyrtimi i njësive të bashkërenditshme në termin e burimit (sakramentet, të kremtet, urdhrat në krishterim dhe tariketet e shartet në besimin muhamedan).

Njësia enciklopedike që ka përhapje në gjithë hapësirën historike shqiptare mund të ndahet vetëm nëse organizimi shtetëror-administrativ e bën këtë të pashmangshme, duke e mbrojtur "Enciklopedinë" nga parcelizimi e fragmentarizimi.



U rekomandua që, me përjashtim të emrave të përveçëm, që kërkojnë teknikisht vendosje në rend të anasjelltë (Shukriu, Edi; Anamali, Skënder), në të gjitha rastet e tjera njësia të shkruhet në rend të drejtë, si në përdorim të përditshëm (Kalaja e Prizrenit, Amfiteatri i Durrësit, Mozaiku i Graçanicës). Për ofiqarët e lartë në institucionet e klerit gjithashtu më e këshillueshme është të paraqiten në rend të drejtë (Tahir efendi Gjakova, Haxhi Dede Reshat Bardhi).

Drejtuesit e redaksive do të vazhdojnë komunikimin me redaksi të tjera të afërta, veç atyre që u përmendën (artet, arsimit, identiteti).

U ritheksua qendrimi që çdo trashëgimi e zhvilluar dhe e ruajtur në mjedisin shqiptar, pavarësisht burimit, do të ketë vendin e vet në "Enciklopedi".

<https://sot.com.al/.../akademike-e-studiuues-ne-takim-per.../>
www.akad.gov.al

Redaksitë e tri fushave: letërsi, arte dhe komunikim, krahasojnë listat e njësive enciklopedike të propozuara prej tyre dhe marrin vendime për përkatësinë e atyre të përbashkëta



Takimet u zhvilluan të hënën dhe të martën. Morën pjesë drejtuesit e dy redaksive, të letërsisë dhe komunikimit, gjegjësisht prof. asoc. dr. Evala Paci dhe z. Naim Zoto; për redaksinë e arteve ishte i pranishëm koordinatori, z. Ben Andoni. Ndoqën "në linjë" me morën pjesë me diskutime ki isprof. dr. Aziz Pollozhani, drejtues i redaksisë së veçantë të ngritur për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut; prof. dr. Valbona Toska e dr. Drita Starova, anëtare të kësaj redaksie. Nga anëtarët e tri redaksive të përmendura më sipër morën pjesë në takim prof. dr. Blerina Suta ("në linjë"), prof. asoc. dr. Belina Budini, dr. Monika Stafa e dr. Rrapo Zguri. Për këto redaksi koordinatori nga redaksia vendore është z. Shaban Sinani (i pranishëm).

Takime të tilla janë zhvilluar e do të zhvillohen midis të gjitha redaksive të një grupfushë.

U vërejt se listat janë tashmë të përbashkëta, por me probleme për t'u zgjidhur.

1. Përzgjedhja e personaliteteve nga letërsia dhe gazetaria nuk i është nënshtruar të njëjtit standard. Redaksitë nuk e kanë zgjidhur ende njësimin e pragjeve të pranimit e të përshkallëzimit në madhësi artikujsh me redaksitë gjegjëse në Kosovë. Ka ende dy shkallë pranimi, njëra përmbledhëse (në Prishtinë) e tjetra përzgjedhëse (në Tiranë). Nëse, për raste të veçanta, gjykohet se mund të bëhet përjashtim, domethënë "gabimi i vetëdijshëm", kjo mund të ndodhë vetëm në fazën përfundimtare, kur fjalësi themelor të jetë miratuar e të jetë shndërruar në prospekt të gjithë "Enciklopedisë".

2. Raporti i përfaqësimit midis së shkuarës dhe bashkëkohësisë ka vend për t'u drejtpeshuar, sidomos në Kosovë, në favor të traditës. U theksua se ky problem duhet të zgjidhet në përputhje me ligjësitë e enciklopedizmit, një prej të cilave është konfirmimi i njësive trashëgimore që i takojnë historisë dhe e kanë mbyllur ciklin.



3. U vërejtën probleme edhe për titullimin e njësive enciklopedike, në shumë raste me strukturë fjalie apo fraze, që të kujtojnë tituj kumtesash, referatesh apo konferencash. U ra dakord që njësitë enciklopedike duhet të emërtohen shkurt, me strukturë togfjalëshi.



4. Shumë personalitete janë dukuri të një kulture tjetër (italiane për arbëreshët,

greke për arvanitët etj.) dhe janë përzgjedhur për meritë të një prekjeje kalimtare të trashëgimisë shqiptare. U rekomandua që këta të trajtohen tek njësia e kulturës shqiptare me të cilën ka lidhje, duke lehtësuar listat jo vetëm numerikisht.



5. Për specifikat që kanë si fusha, redaksitë e letërsisë, arteve dhe komunikimit (të sporteve gjithashtu) mund të rezultojnë me një raport specifik midis emërtimeve të përveçme e atyre të përgjithshme. Për një përzgjedhje serioze drejtuesit e redaksive duhet të njohin hierarkinë e titujve të nderit, të mjeshtërisë e të kontributeve që janë dhënë në Shqipëri e në Kosovë (duke përfshirë ato të periudhës jugosllave); çmimet dhe konkurset, rekordet në sport, mirënjohjet dhe vlerësime të tjera, që është kërkuar të përdoren si kritere ndihmëse.

6. Breznitë, grupimet, rrjedhat e përbashkëta në letërsi e gazetari, të trajtohen në artikuj përmbledhës, duke përmbajtur në brendësi të tyre përveçime të mundshme.

7. Redaksitë e ngritura për letërsinë, artet, komunikimin, sportet dhe historinë nga fillimet deri tek Rilindja Kombëtare mund të bëjnë një takim të tretë jashtë rendit të rregullt me redaksitë e njëjta në Kosovë.

Takime të redaksive të "Enciklopedisë shqiptare" sipas ndarjes në grupfusha



- Redaksia për sociologjinë dhe redaksia për drejtësinë e sistemet politike përfundojnë diskutimet në nivelin e grupfushës; të nevojshme takime të tjera, me redaksinë e letërsisë dhe me atë të religjioneve -

- Redaksia për gjeografinë fizike paraqet propozimet e veta për riadresimet e disa njësive enciklopedike tek redaksia për mjedisin; i domosdoshëm diskutimi me redaksinë e gjuhësisë për çështje të etnogjeografisë, etimologjisë, historisë së toponimeve në të gjitha nivelet: makro, media e mikrotoponime -

- Grup-redaksitë dhe pjesëmarrësit në takimet e datës 29 gusht:

Nga redaksia për shkencat shoqërore - drejtuesi i saj prof. dr. Gjergj Sinani. Nga redaksia për sistemet politike e drejtësia, akad. Aurela Anastasi dhe koordinatori nga redaksia vendore e Tiranës - akad Kosta Barjaba (online). Nga redaksia e gjeografisë fizike (30 gusht), prof. dr. Skënder Sala, prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri, prof. dr. Pal Nikolli, dr. Ermiona Braholli; koordinatori i caktuar për grupfushën nga redaksia vendore prof. dr. Perikli Qiriazi.

Në të dy takimet redaksia e posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut e përfaqësuar nga drejtuesi i saj prof. dr. Aziz Pollozhani (online).

Sipas rekomandimit të redaksisë vendore - të pranishëm dr. Arian Leka (QBEA) dhe prof. dr. Shaban Sinani (redaksia vendore).

Dy nga redaksitë punojnë me fjalës të bashkuar Shqipëri-Kosovë; redaksia e

gjeografisë fizike në fazën përmbyllëse.

Gjatë takimeve u konkludua edhe për integrimin e fjalësit të redaksisë së posaçme të MV: për shkencat shoqërore 15 artikuj dhe për sistemet politike 13 artikuj.

U adresuan problemet e mbivendosjes së disa njësive enciklopedike, si për personalitetet, ashtu edhe për termat e përgjithshëm, duke i parashikuar në përgjegjësi të redaksisë ku shfaqet kontributi parësor, në respektim të kriterit të fushës kryesore.



Gjatë këtyre takimeve u vërejt domosdoshmëria e bashkëpunimit edhe me disa redaksi të tjera të disiplinave me afri e zona të përbashkëta kontakti. Redaksia për shkencat shoqërore ka përfshirë në fjalësin e saj njësi që i takojnë sidomos letërsisë, gjuhësisë, historisë, religjionit, trashëgimisë e komunikimit, të parashikuara edhe prej tyre. Njësitë për Beçikemin, B. Palajn, A. Pipën, A. Xhuvanin, Gjon Shllakun, Br. Merxhanin, P. Bogdanin, Vangjel Koçën, E. Koliqin, Mehdi Frashërin, Lumo Skëndon, Mustafa Krujën, Eqrem bej Vlorën etj., u vendos të kalojnë në përkatësi të këtyre redaksive. Kështu edhe për disa nocione kategoriale si estetika (letërsi), besa dhe identiteti (trashëgimi), etnia dhe kombi (histori).

U theksua se ndarja e njësive sipas përkatësisë së fushës duhet të kuptohet si çështje disiplinimi, por termi do të hyjë në enciklopedi me të gjitha përbërëset e veta: historike, kulturore, gjuhësore, duke mundësuar praninë e botës shqiptare në to. Njësitë enciklopedike para së gjithash janë trashëgimi (dhe kjo u jep rëndësi nëndisiplinave të tilla si etnogeografia).

Dy redaksitë për sistemet politike e drejtësinë, në Tiranë e në Prishtinë, personalitetet kanë konsideruar të përfshihen tek njësitë tematike dhe entet; por

përveçimi i më të rëndësishmëve prej tyre si artikuj më vete është i domosdoshëm.

Subjektet me funksione të ngjashme në Shqipëri e Kosovë, në përputhje me parimet e enciklopedizmit, si rregull duhet të paraqiten në një njësi të përbashkët enciklopedike, duke iu referuar njëjtësisë së funksionit e shërbimit, në çdo rast që ndikimi i faktorëve historikë apo i ndarjes me kufij të shumëfarshëm nuk ka qenë i tillë që të bëhet pengesë. Për këtë, nëse është e nevojshme, mund të kërkohet që redaksitë e niveleve vendore e qendrore të bëjnë saktësime në strukturën e artikullit, duke parashikuar nëntituj e nëndarje, që lehtësojnë edhe përshkrimin e specifikave.



Takimi përgatitor për kalendarin e punës të muajit shtator me redaksinë e gjeografisë fizike, që e ka integruar prurjen e parë të fjalësit të redaksisë së posaçme të MV dhe po punon për përfshirjen e prurjes më të fundit me 37 njësi enciklopedike, u zhvillua më 30 gusht.

Për diskutimin e nisur me redaksinë e mjedisit (paraqitur edhe në një relacion me shkrim) u vendos që termat që lidhen me rregullimin juridik-administrativ të ekosistemeve natyrore (ligje, konventa, protokolle, standarde vendore e europiane), të qendrojnë tek redaksia e mjedisit (zonë e mbrojtur, ekologji), pavarësisht se për informacionin dhe argumentimin shkencor do të duhet edhe bashkëpunimi i redaksisë së gjeografisë fizike.

U dakordësua që, në përputhje me rekomandimet e mbledhjes së RQ, forma tradicionale e emërtimeve sipas ndarjes etnokrahinore, realizuar nga personalitete të tillë shkencorë si Rrok Zojzi e Mark Krasniqi, të jetë përparësore ndaj emërtimeve sipas

ndarjes administrative.



U kërkua bashkëpunim mes redaksive, sidomos me atë të gjuhësisë, por dhe të historisë, për çështjen e burimit gjuhësor prej periudhës parashqipe të shumë termave dhe emërtimeve të propozuara në fjalësin e gjeografisë fizike, për të shfaqur përmes toponimit apo hidronimit edhe lashtësinë etnike-kulturore, sjellë përmes etimologjisë, shquarjes për shkak të ngjarjeve historike shqiptare që kanë ndodhur aty apo pranë tij (Sharri, Vjosa, Drini, Shasi etj.). Në bashkëpunim me redaksinë e gjuhësisë, për disa toponime, para se të bëhet përkthimi si njësi e përvetshme, duhet shpjeguar kuptimi burimor ("mat", "fâng", "dêjë", "vā" etj.).

Redaksia e bujqësisë dhe redaksia e mjedisit sot në takim pune për të diskutuar e vendosur për lëndën enciklopedike në pikëtakim mes tyre



- Të nevojshme takimet për fjalësin e "Enciklopedisë" edhe me redaksinë e mjedisit dhe atë të gjeografisë fizike -

- Ka ende ndonjë mbivendosje dhe për fusha më të ngushta, si ushqimi, produkti ushqimor, teknologjia dhe industria ushqimore, zooveterinaria -

- Redaksia e mjekësisë informon për përfundimin e diskutimeve me redaksinë gjegjëse në Prishtinë për realizimin e fjalësit të përbashkët -

- Akad. Anila Hoda, anëtare e redaksisë vendore të Tiranës, e ngarkuar prej saj si koordinatore e grupfushës, drejton bashkëbisedimin -

- E pranishme "në linjë" prof. dr. Valbona Toska, përfaqësuese e redaksisë së posaçme të ngritur në Maqedoninë e Veriut për trashëgiminë shqiptare atje -

- Akad. Nazim Gruda, akad. Nestor Thereska, akad. Fatbardh Sallaku, prof. dr. Mihallaq Qirio, prof. dr. Hajri Hasko, prof. dr. Seit Shalari, drejtues e anëtarë të këtyre tri redaksive të fushave; si dhe dr. Arian Leka (QBEA) e Shaban Sinani (redaksia vendore) - pjesëmarrës në takim -

U vërejt me kënaqësi se redaksia e bujqësisë, redaksia e mjedisit dhe ajo e mjekësisë e kanë kaluar fazën e diskutimeve me redaksitë gjegjëse në Kosovë sa i takon fjalësit të përbashkët.

Për njësitë enciklopedike "në kufijtë mes tyre" u morën vendime sipas kriterit të fushës kryesore.

U identifikuan njësi enciklopedike që mund t'i kalojnë një redaksie tjetër (biologji, gjeografi fizike, ekonomi).

U kërkua respektim i specifikave të fushës dhe organizim i strukturës së lëndës dhe njësive enciklopedike sipas veçantive të tyre.



Disa nga problemet që dolën dhe që duhet të zgjidhen analogjikisht edhe në redaksi të tjera:

1. Titullimi i njësisë) artikullit enciklopedik. Emërtimet analitike-perifrastike, me strukturën e një titulli kumtесе, referati, kapitulli, duhet të kalojnë nga kategoria "temë" në atë të njësisë, duke i shprehur me fjalë-çelës apo togfjalësh;



2. Njësitë teorike të përgjithshme teknike të disiplinave shkencore do të trajtohen

jo si në një fjalor terminologjik, por duke marrë me vete çka lidhet me botën shqiptare (historinë e përdorimit, burimin, studiuesit kryesorë, mjedisin shqiptar); sipas parimeve të enciklopedizmit;



3. Është i pamjaftueshëm cilësimi "artikull i përbashkët" për njësitë e propozuara që të mos qendrojnë më vete. Personalitetit që bashkohet në një artikull përmbledhës duhet t'i gjenden "të ngjashmit" në shkallën e përfaqësimit, në historinë e dukurisë, zhvillimit apo institucionit;



4. Kur është e mundur, njësia enciklopedike që del dy herë vetëm për shkak të veprimt të kufirit apo për ndonjë arsye historike-administrative, shprehet me një fjalë-


çelës me karakter konvergues dhe në strukturë respektohen me nëntituj specifikat rajonale; duke vlerësuar më të rëndësishëm homogjenitetin e lëndës vetë në përmbajtje;

5. Disa emërtime të përveçme (konventa, programe ndërkombëtare) që dalin shumë herë (deri mbi 15 herë vetëm në një fushë); ose nënlojet e së njëjtës përmbajtje; mund të grupohen tek termi themelor dhe në brendësi të shtjellohen njëri pas tjetrit (duke lënë më vete konventat kryesore në të cilat bëjnë pjesë Shqipëria e Kosova, kodet themelorë ndërkombëtarë), për të shmangur analitizmin dhe fragmentarizmin;

6. Redaksitë e bujqësisë dhe të mjedisit përfaqësimin e personaliteteve kanë propozuar ta zgjidhin kryesisht përmes njësive tematike apo entit/subjektit ku kanë lënë gjurmë (institucion, shërbim, njësi kërkimore a drejtimi). Por kjo nuk mjafton, çdo fushë duhet të ketë edhe përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të saj dhe është pikërisht koha për të bërë plotësimet. Ndërsa redaksia e mjekësisë ka diskutuar me kolegët në Kosovë vetëm për emërtimet e përgjithshme (jo dhe për personalitetet, pa njësim paraprak të pragjeve).

Promovime

Jo vetëm në nanoshkencë e albanologji, por edhe në studimet shoqërore



- Akademia e Shkencave, një pol konvergjence e bashkëpunimi për diasporën intelektuale në drejtësi, mirëqeverisje, sociologji, ekonomi e financë -

(Platforma e mirënjohur e botimeve të numerizuara www.academia.edu publikon të plotë vëllimin "Shteti i së drejtës në kuadër të integrimit evropian të Shqipërisë")

"Shteti i së drejtës në kuadër të integrimit evropian të Shqipërisë (vështrime të studiuesve shqiptarë të së drejtës në diasporë)" është publikuar në version "në linjë" në platformën e njohur të botimeve shkencore të numerizuara www.academia.edu.

Vëllimi është një botim i Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2023) dhe përmban kontributet shkencore të studiuesve shqiptarë të diasporës në fushën juridike që iu

përgjigjen ftesës së saj për t'u përfshirë në diskutimet shkencore të dekadave të fundme lidhur me proceset e eurointegrit, kushtetutshmërisë, mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës.

Platforma www.academia.edu, që e ka publikuar të plotë “në linjë”, e ka kategorizuar në studimet europiane (“european studies”), ligjshmëri kushtetuese (“constitution law”), integrim europian (“european integration”) dhe drejtësi (“justice”).

Shenjim i www.academia.edu:

Vëllimi paraqitet edhe si një bashkëbisedim [i autorëve] me studiuesit që jetojnë e punojnë brenda vendit; si një shkëmbim idesh për mbarëvajtjen e shtetit të së drejtës me qasje nga integrimi europian i Shqipërisë. Punimet trajtojnë një larmi konceptesh, të cilat u drejtohen studiuesve të së drejtës, lexuesve juristë, studentëve, si dhe të gjithë profesionistëve që shërbejnë në sektorë të ndryshëm, qofshin publikë a privatë. Libri përmban edhe një përmbledhje në gjuhën angleze.

Përveç hyrjes nga dy përgatitësit, platforma informon se vëllimi përmban artikuj e studime nga (ndër të tjerë): Aurela Anastasi, Andi Hoxhaj, Arsim Bajrami, Darinka Piqani, Klodian Rado, Ledi Bianku, Enika Abazi, Gentian Zyberi, Fabian Zhilla, Entela, Rudina Jasini.

Lista e plotë e autorëve gjendet në ilustrimet bashkëmbyllur këtij njoftimi.

Vëllimi mund të këshillohet i plotë në linkun:

https://www.academia.edu/.../SHTETI_I_S%C3%8B_DREJT%C3...

Libri është përgatitur për botim nga akad. Aurela Anastasi dhe akad. Shaban Sinani.

Aktivitete

Seminari i 42-të ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, që organizohet në gusht nga Universiteti i Prishtinës, vjen sivjet bashkë me 50-vjetorin e themelimit të tij nga UP

(U themelua në vitin 1974, por pati raste ndërprerjeje, për shkak të gjendjes politike në Kosovë)



Përveç nëntë ligjëratave, që do të paraqiten nga albanologë të huaj dhe studiues vendës, janë parashikuar edhe 67 kumtime e paraqitje shkencore nga gjuhëtarë, historianë të letërsisë, të kulturës e të qytetërimit.

Në sesionin tradicional treditor të përvitshëm për gjuhën, letërsinë dhe kulturën, që organizohet në kuadër të seminarit, janë në program të mbahen 45 kumtesa, me prani fizike dhe në linjë.

Midis ligjëruesve, nëntë janë akademikë, anëtarë të jashtëm apo anëtarë nderi të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë: Francesco Altimari, Leonardo di Savoia, Brian Joseph, M. Floristan, Rexhep Ismajli, Mehmet Kraja, Kujtim Shala, Victor Friedman, Shaban Sinani.

Punonjës të instituteve kërkimore-shkencore të rrjetit të Akademisë së Shkencave që marrin pjesë me kumtesa (sipas rendit në program) janë: Enklejda Kapia, Ledi Shamku-Shkreli, Merita Sauku-Bruçi, Mimoza Shqefni, Edmond Cane, Klara Kodra, Vilma Proko.

Akad. Shaban Sinani është ftuar nga drejtori i seminarit akad. Bardh Rugova të mbajë, më 22 gusht 2024, ora 11.00-12.30, ligjëratën “Një vështrim krahasues letërsisë sociale në Ballkan në periudhën midis dy luftërave”.

Në këtë ligjëratë do të shërbehen argumente të sistemuara për ekzistencën e një rrjedhe të përbashkët panballkanike në zhvillimin e letërsisë në vitet 1920-1930, pavarësisht se në studime ajo është njohur e vazhdon të njihet me emërtime të

ndryshme ("avant-garde", "lost generation", "futurizëm i majtë" / "levnij futurizam"; "late futurism" / "futurizëm i vonë"; "jugofuturizëm", "zenitizëm", "konstruktivizëm/konsi", "krepuskularizëm", "literature of decadence").



Jashtë terminologjisë letrare, për krijimtarinë e të gjithë autorëve që krahasohen në këtë ligjëratë (shqiptarë, malazezë, kroatë, serbë, bosnjakë, maqedonas, bullgarë), janë përdorur emërtimet "letërsi e mjerimit", "letërsi e protestës", "letërsi e zhgënjimit" dhe "letërsi sociale". Nuk kanë munguar emërtime nga më kundërthënëset, që nga "letërsi e dëshpërimit", deri tek "prekursorë e realizmit socialist".

Si dukuri që u zhvillua përmbi kufijtë shtetërorë, në kërkim të së përbashkëtës, është parapëlqyer emërtimi "letërsi sociale", që njihet edhe në studimet europiane referuar autorëve të tillë si Henri Barbusse, Bertolt Brecht e Louis Aragon në Perëndim dhe V. Majakovski e A. Blok në periudhën e hershme parasovjetike të krijimtarisë së tyre e pak vite më pas.

Në këtë rrjedhë përafrohen mes dallimesh poetët: Migjeni, shqiptar; Radovan Zogović, malazez, me poemën "Došljaci - pjesme Ali Binaka" / "Ardhësit, këngët e Ali Binakut); Srečko Kosovel, slloven, me vëllimet "Pjesme" dhe "Integrali", i njohur si përfaqësues i rrymës "konsi", shkurtim për "konstruktivist", titull i një reviste letrare në Slloveni, që bashkonte poetët solidarë me "Trattato di rapallo and italianization"; Đuro Sudeta, kroat, i cilësuar si "poet i ankthit dhe rrënimit", me vëllimet "Osamljenim stazama" / "By lonesome paths" dhe "Kućice u Dolu" / "Little houses in Dol"); Miloš Crnjanski, serb, autor i "Objašnjenje-s" për veprën "Sumatra", që u dha karakter

programor ndryshimeve në vjershërim, duke refuzuar prozodinë e mëhershme të romantizmit, që mbështetej në traditën popullore, dhe shpalli si model metrike e vjershërimi “vargjet e lira” / “sllobodne stih”. Një nyje e rëndësishme e nënsistemit të letërsisë sociale në Ballkan, e asaj letërsie që shpesh quhej edhe “e poetëve të zhgënjyer” (“pisateli razočarani”), një term i përdorur më herët nga italiani Sergio Corasini, është kroati Miroslav Krleža, me tre vëllimet e para me poezi, “Pjesme I”, “Pjesme II” dhe “Pjesme III”, që u takojnë tri dekadave të para të shekullit XX. Poema e tij “Gospođa u posjeti kod bolesnog djeteta svoje sluškinje”, kanë lënë gjurmën e vet ndikuese në “Poemën e mjerimit” të Migjenit, si në vargëzim, ashtu dhe në frymë. “Poema e mjerimit” është gjithashtu lehtësisht e krahasueshme me “Mbrëmjet dimërore” (“Зимни вечери”) të bullgarit Hristo Smirnenski (Христо Смирненски).

Poezia e Migjenit hyn në krahasim edhe me veprën e kroatit Đuro Sudeta apo të bosnjakut Antun Simić: bashkëkohës të tij, me të njëjtin fat vetjak, poetë të dëshpërimit, protestës dhe të un-it poetik kolektiv, të identifikimit me fatin e pjesës më të pambrojtur të shoqërisë.

Një poet tjetër për të studiuar nënsistemin e letërsisë sociale ballkanase mund të jetë maqedonasi Kosta Racin (Kočo Racin, Кочо Рацин), me vëllimin e tij të vetëm poetik “Pesni” (Skopje 1939). Poezitë e hershme të Esad Mekulit (Sad Nokšić) janë të së njëjtës rrjedhë.

Kjo letërsi u zhvillua ku më pak e ku më shumë nën ndikimin e Traktatit futurist të Marinetti-t.

Poetët e kësaj rrjedhe thujse të gjithë patën edhe fat të keq vetjak: vdiqën të rinj nga sëmundja (tuberkulozi).

“Konstruktivistët”, “konsi-t”, krepuskularistët” sllovenë; “zentististët” serbë, “deziluzionistët” / “razočarani” kroatë, serbë, bosnjakë, bullgarë e maqedonas; pavarësisht nëse i drejtoheshin Nietzsche-s apo Schopenhauer-it; pavarësisht nëse ishin të dëshpëruar prej fantazmës së fashizmit; pavarësisht ndikimeve prej “brezit të humbur” nga njëra anë dhe të mendimit të majtë europian nga ana tjetër; pavarësisht se shkruan letërsi të angazhuar, bashkohen në qendrimin ndaj shqetësimeve ekzistenciale të shoqërisë në të cilën jetuan.

<https://www.pressreader.com/.../20240813/281814289169420>

<https://filologjia.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,35,1043>

<https://filologjia.uni-pr.edu/.../3C11DEBA-BF59-465C-AACE...>

<https://frekuenca.net/.../35631-seminar-nderkombetar-per...>

<https://www.oranews.tv/.../seminar-nderkombetar-per...>

<https://www.google.com/.../seminar-nderkombetar-per.../>

<https://ata.gov.al/.../seminar-nderkombetar-per.../>

<https://www.kultplus.com/.../me-19-gusht-fillon-punimet.../>

https://youtu.be/H_3X9TAP2XA?si=PCXPJdGLEwIPH1nl

<https://www.koha.net/.../seminari-ne-gjysmeshekull...>

[**https://www.facebook.com/share/q2jA5MPASyGBQ2ZL/?mibextid=oFDknk**](https://www.facebook.com/share/q2jA5MPASyGBQ2ZL/?mibextid=oFDknk)

<https://kallxo.com/.../seminari-i-shqipes-sislej-xhafa.../>

<https://katror.info/me-19-gusht-nis-punimet-seminari.../>

<https://katror.info/prishtina-feston-50-vjet-albanologji/>

https://youtu.be/w9qSE_mFJgc?si=zdGFvjF0dgzRg1NB

<https://www.koha.net/.../seminari-ne-gjysmeshekull...>

Seminari i 42-të ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare

Në seminarin e 42-të ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare referuan gjuhëtari Leonardo M. Savoia (anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe bashkëpunëtor i njësisë për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët pranë saj); gjuhëtari indoeuropeist Brian Joseph e historiani i Mesjetës Jose Maria Floristan, të dy anëtarë nderi të ASHSH.

Përmbledhje të refererimeve:

I. Leonardo M. Savoia:

"Non-finite clauses in Albanian: a Balkan feature"



1. This contribution addresses the complementation system of Albanian and Aromanian varieties in contact with Albanian, the minority Romance languages spoken in the Southern regions of Albania. Balkan languages are mainly known as characterized by the finite verbal syntax in dependent contexts (Joseph 2020), where Romance and Germanic languages present infinitives. Nevertheless, in certain Balkan languages non-finite verbal forms occur in dependent clauses, also in alternance with

finite structures, and show special properties. Schematizing, we find in Tosk/ standard Albanian a generalized use of finite dependent clauses in control contexts, as in:

(1a); in some environments, an alternative participial construction shows up, introduced by the preposition *për* 'for' in (1b), in oblique case, in (1c), introduced by *pa* 'without', in (1d), and in gerunds. In all contexts Gheg shows a periphrastic construction where the preposition *me* 'with' combines with an invariant form of the participle, in

(2).

(1) a. *filova tə ha Gjirokastër*

I.began Art I.eat 'I began to eat'

b. *arđtj për t a larə*

I came for Art it washed 'I came to wash it'

c. *mbarəva sə ŋgrən-i atə*

Istopped Art.Obl eaten.Obl that 'I stopped eating it'

d. *dəla pa ε parə*

I.came.out without him seen 'I came out without seeing him / her'

(2) *kə fi 'tu mə hō ŋər Shkodër*

I have finished to eat 'I finished eating'

Aromanian, like Tosk varieties, selects finite constructions, however in alternation with non-finite forms of the verb, where the infinitive is introduced by a preposition, *di* 'of' or *ti* 'for', in (3a). 'Without'- verb is expressed by *ni*+participle, in (3b). Other occurrences of infinitive copy Albanian.

(3) a. *tsə dzɛf di (nu) fətsəri / tsi (nu) s u fats Libofshë to.you I.said of Neg do /Prt*
(Neg) Prt it do.2sg 'I told you (not) to do it'

b. *nifai ni fapət(atseu)/durmit/ɣat*

I.came.out Neg made (it)/slept/ washed

'I came out without making it/ sleeping/ washing myself'

2. Interesting issues emerge from the comparison between Albanian (standard and dialects) and Aromanian, also in relation to Modern and Early Romanian (Hill 2013), as highlighted by Manzini and Savoia (2018). We discuss new data and pursue a different syntactic approach based on recent articles by Chomsky (Chomsky 2020, 2021) which reject head movement and cartographic analysis. We assume the Phasal model of the sentence, in which the verbal form is sufficient to realize the features of the Phase C-T. We see that sentential embedding (Romance, English) requires some kind of nominalization. The theoretical point is that sentences lack the phi-features which are necessary to embed nominal argument (subject or object). This potential problem is overcome by resorting to the relativization strategy through a complementizer observed with finite clauses, or obliquization. The latter solution amounts to structures in which a

preposition or the oblique morphology introduce the participle in Albanian and infinitives in Aromanian. These introducers make the dependent clause interpretable by assigning it the status of a predicate associated with the event.

II. Jose M. Floristan:

"The Albanian communities of Naples and Sicily (16th and 18th c.) between the Balkan revolt and service to Spanish crown"



The Albanian emigration from the Balkans to the kingdoms of Naples and Sicily was more or less constant throughout the 16th century. They settled preferably in regions of eastern Apulia, Calabria and western Sicily. Most of them were engaged in agricultural and livestock farming. Others joined the militia, as stradiotes or as agents of espionage at the service of the Spanish authorities. In general, their adaptation to their new destination was satisfactory. In the religious level they gradually accepted their incorporation to the Church of Rome, and in the political and social level they were loyal vassals of the kings of Spain.

III. Brian Joseph:

"Geography and language: a tale of two villages"

Seminari,
50 vjet.

Brian
Joseph

Distinguished University
Professor, Kenneth
E. Naylor Professor
Emeritus at the Ohio
State University



The linguistic dimension to the relatively new science known as geoanthropology has historically been under-explored, despite the obvious relevance of linguistics for anthropology and of geography for language development. Partly by way of remedying this gap and basing myself on fieldwork I have done over the past decade or so on the Greek of various enclaves in southern Albania, I report on the linguistic situation in two villages in the region that are in very different geographic circumstances and show differential vitality of the Greek language. To reach a point where this case-study can be productively discussed, I provide some general considerations as well on the interaction between geography and language in other parts of the Balkans and other parts of Europe.

Në sesionin shkencor që zhvillohet në kuadër të Seminarit të 42-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (Prishtinë) referuan:

1. Prof. asoc. dr. Evalda Paci (përgjegjëse e departamentit të letërsisë të IGJL):
"Rreth studimeve mbi tekstin dhe për tekstin në letërsinë e shkruar shqipe";



2. Prof. dr. Blerina Suta (bashkëpunëtore e njësisë kërkimore-shkencore për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët): "Burime të panjohura të veprës së De Radës dhe të receptimit të saj gjatë qëndrimit në Napoli";



3. Prof. dr. Enkeleida Kapia (IGJL) dhe dr. Josiane Riverin (Coutlée/Gjermani):
"Kur tiparet i rezistojnë ndryshimit: studime mbi rrafshimet dialektore në gegërishte"



Në vijim përmbledhje të shkurtra të kumtesave:

I. Prof. asoc. dr. Evalda Paci (përgjegjëse e departamentit të letërsisë të IGJL):
"Rreth studimeve mbi tekstin dhe për tekstin në letërsinë e shkruar shqipe":

Hulumtimi përmbajtësor i teksteve të mëhershme shqipe përbën një linjë studimore sa të përveçme, aq dhe të vyer në pikëpamje të brendësimit të elementeve të brendisë e të veçorive të ndërtimit në veprat përkatëse. Një orientim i tillë studimor ka shfaqje tipike që në dekadat e para të shekullit të kaluar, por me një prirje që vjen e konkretizohet në një mënyrë graduale, bashkë me konsolidimin institucional të të përkohshmeve që përfaqësonin tribuna të mirëfillta të pasqyrimit të zhvillimeve letrare, gjuhësore e kulturore në vendin tonë. Në traditën e studimeve tona njihet një gradualitet i natyrshëm që punën me tekstin dhe hulumtimet përkatëse i evidenton dhe në vështrim të qasjes filologjike e kritike, si një përfrim i çmuar më së pari në pikëpamje metodologjike. Vetë botimet filologjike e kritike të veprave të letërsisë së

vjetër shqipe përfaqësojnë në vetvete shkolla të përveçme të metodologjisë ekdotike, duke e bërë më të larmishëm vetë kuadrin e konfigurimit të tyre. Në të vërtetë, çdo realizim i kësaj natyre, çdo botim i këtyre veprave përbën një hap më vete dhe një kontekst të mëvetësishëm qasjesh, zgjidhjesh dhe orientimesh që nuk mjaftohen vetëm në qëmtime filologjike rreth aspekteve grafike të brendisë së tyre, por dhe mbi një histori më vete që qëndron mbas realizimit të secilit prej përpilimeve që është pjesë e panoramës historike të shekujve XVI-XVIII. Megjithatë, hollësitë grafike e interpretimet grafematike janë një udhërrëfyes për studiuesit që në mungesë të dhënash më konkrete e më të sakta mbi rrethanat e përvijimit të veprave të caktuara, përpiqen të hedhin dritë mbi pjesë të munguara të historikut të tyre, duke plotësuar kësisoj trajtesa të domosdoshme në lidhje me historishkrimin, por dhe me historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Një aspekt vërtet për t'u vlerësuar mbetet dhe fakti që falë njohjes së kontekstit të realizimit të veprave të kësaj periudhe, hidhet dritë dhe mbi institucione të mirëfillta të kohës, që kanë të bëjnë me edukimin, por dhe me kulturën e shtypshkrimit, si një qasje e mirëfilltë e natyrës teknologjike dhe shoqërore.

II. Prof. dr. Blerina Suta, "Burime të panjohura të veprës së De Radës dhe të receptimit të saj gjatë qëndrimit në Napoli"

Kumtesa plotëson, me materiale të hulumtuara në bibliotekat dhe arkivat e Napolit, një periudhë mjaft të rëndësishme në formimin e De Radës, atë të viteve 1838-48 kur poeti i Makit qëndroi në Napoli. Veç botimeve të panjohura të De Radës dhe për De Radën në periodiket e kohës, kemi pasur mundësi të rindërtojmë në mënyrë më të detajuar periudhën e vëzhgimit dhe burgosjes nga qeveria e burbonëve, gjë që reflektohet dhe në veprën e tij të mëvonshme.

III. Enkeleida Kapia dhe Josiane Riverin (Coutlée/Gjermani): "Kur tiparet i rezistojnë ndryshimit: studime mbi rrafshimet dialektore në gegërishte"

Në këtë ligjëratë përqendrohemi tek disa nga studimet tona të fundit mbi rrafshimet dialektore (angl. "dialect levelling") në gegërishten jugore. Së pari, paraqesim rezultatet e një studimi kryer me informatorë të rritur dhe fëmijë (në klasën e parë) që jetojnë në zona urbane dhe rurale. Sakaq që komunitetet urbane dhe rurale dëshmojnë rrafshime dialektore për disa tipare gjuhësore, një prej këtyre tipareve mbetet krejt i pandryshueshëm, i.e. gjatësia fonologjike e zanoreve. Studimi i dytë u konceptua për të hulumtuar nëse gjatësinë e zanoreve pëson ndryshime në gjuhën e fëmijëve nën ndikimin e standardit nga klasa e parë derisa mbërrijnë në klasën e pestë. Përfundimet e këtij studimi konfirmojnë sërish qëndrueshmërinë e këtij tipari në gegërishten jugore. Pra, fëmijët, pavarësisht kontaktit ditor me standardin, dëshmojnë vlera të pandryshueshme të gjatësisë së zanoreve nga klasa e parë në klasën e pestë. Në studimin e tretë qëllimi ishte eksplorimi i rolit të qëndrimeve (angl. "language attitudes") ndaj disa tipareve gjuhësore nga folës gegë e toskë. Rezultatet tregojnë që

tiparet geqe që kanë filluar të rrafshohen vlerësohen negativisht nga folësit. Nga ana tjetër, gjatësia e zanoreve, e cila vazhdon të jetë tipar i qëndrueshëm, vlerësohet pozitivisht dhe nuk dallohet aspak si tipar identifikues i gegërishtes. Këto përfundime të marra së bashku do të integrohen në një diskutim mbi rolin e bashkërenduar të faktorëve gjuhësorë dhe atyre shoqërorë në procesin e stabilitetit dhe rrafshimit të dialekteve në gjuhë.

Të tjera

"How to think about the instrumental politics of mass rape: a critical appraisal of feminist approaches"



- Artikull i sapobotuar i akad. Albert Dojës në "The International Review of Human Rights", vijim i një artikulli më të hershëm të tij, botuar pesë vjet më parë -

Për kontekstin në të cilin u shkrua ky artikull, autori, akad. Albert Doja, në rrjetet sociale ndër të tjera shkruan:

"Pesë vjet më parë, në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, isha i lumtur që botova në "Journal of Crime, Law and Social Change" një artikull kushtuar grave boshnjake dhe kosovare që vuajtën në heshtje për t'i rezistuar politikës barbare serbe (shih: <https://doi.org/10.1007/s10611-018-9800-0>).

U përpoqa në atë artikull të depërtoja përtej rrëfimeve stereotipe të përdhunimeve masive dhe të zhvilloja një model neo-strukturor të formalizimit kanonik të bazuar në analizën e ligjërimit dhe morfodinamikën transformuese, duke

marrë drejtimin nga operacionet abstrakte matematikore dhe transformimet kanonike të sugjeruara nga Lévi-Strauss për studimin strukturor të miteve.

Artikulli shkaktoi sulme të ashpra, të fokusuara jo në përmbajtjen e tij, por kundër Kosovës e kundër shqiptarëve, kryesisht nga lobet serbe, por dhe nga "zgjatimet" e tyre "feministe", të cilave iu bashkuan edhe disa "feministe" shqiptare të Kosovës, thjesht për shkak të angazhimeve të tyre në këto lëvizje.

Qëllimi i tyre i përbashkët ishte për të legjitimuar krimet e luftës dhe për të shfajësuar kriminelët; duke lehtësuar kështu rrugën e negociatave të Serbisë për anëtarësim në Bashkimin Europian. Nuk ishte për t'u çuditur që edhe një pjesë e mediave ndërkombëtare u përqendruan vetëm në "fajin kosovar".

Në këtë artikull të ri unë çmontoj manipulimin me qasjet feministe dhe ofroj një vlerësim kritik të rrëfimeve stereotipe dhe relativizuese të publikimeve të studiuesve me të vërtetë me vokacion feminizmin dhe të të drejtave të njeriut, në një kritikë shumë të nevojshme për një qasje antropologjike të vëmendshme ndaj ideologjisë dhe aktivizmit kulturor.

Përdhunimi masiv dhe format e tjera të dhunës seksuale në konfliktet etnike, siç tregoi incidenca e tyre në luftërat e Bosnjës dhe Kosovës në ish-Jugosllavi në vitet 1990, nuk mund të relativizohen duke përdorur një strategji të "viktimizimit. Nocionet e supozuara patriarkale të nderit dhe gjakut nuk mund të merren në mënyrë jokritike si tipare kulturore të detyrueshme që duhet të përcaktojnë sjelljen shoqërore".

Duke përgëzuar kolegun Albert Doja për këtë artikull të ri të sapobotuar, shenjojmë se ju mund ta lexoni të plotë atë në linkun e mëposhtëm:

<https://www.tandfonline.com/eprint/AEXVXV3FY3XJDZKX3BNY/full?target=10.1080/13642987.2024.2377753>

Përfaqësim cilësor i letërsisë shqipe sot në shtypin letrar kroat



- Një numër me profil ekskluziv shkrimtarin dhe studiuesin "Arian Leka"
- Revista "Tema" në Zagreb boton tregime, poezi dhe një rrëfim nga autori i ftuar
- Përkthimi kroatisht nga botimi në gjuhën angleze nga Željka Somun

- Nën titullin e përbashkët "Aleph u Zagrebu" / "Aleph-i në Zagreb" - botohen:

1. "Nemoj o svemu pisati; nemoj sve ispričati! / "Nuk mund të shkruhet për gjithçka / Nuk mund të rrëfehët gjithçka";
2. "Braća Grimm u Zagrebu" / "Vëllezërit Grimm në Zagreb";
3. "Dječak koji izgubio more" / "Djaloshi që humbi detin";
4. "Odakle dolazi svetlost" / "Nga vjen kjo dritë";
5. "Novi pazar u Tiranu" / "Pazari i ri në Tiranë";
6. "Na pijaci plaćati lekama" / "Barnat paguhen si në treg";

7. "Zapisi za svasvačke: Arian Leka: "Aleph u Zagrebu" / "Të dhëna të përgjithshme: Arian Leka - "Aleph-i në Zagreb".



Për lexim të plotë linket në vijim.
Përgëzime miku ynë Arian Leka. Përfaqësim cilësor i letërsisë shqipe sot.
<https://mvinfo.hr/.../arian-leka-djecak-koji-je-izgubio-more>
<https://magazin.fraktura.hr/.../arian-leka-odakle-dolazi...>
<https://booksa.hr/proza-i-poezija/proza/novi-pazar-u-tirani>
<https://fokalizator.me/na-pijaci-placati-lekama/>
<https://tacno.net/novi-pazar-u-tirani/>
<https://fokalizator.me/djecak-koji-je-izgubio-more/>
<https://www.rezidencija.dhkp.hr/post/zapisi-sa-svačke-arian-leka-aleph-u-zagrebu>
<https://fokalizator.me/odakle-dolazi-svjetlost/>

**Akad. Rexhep Meidani shkruan për Hasan Tahsinin, matematikan shqiptar,
filozof e astronom, rektor i parë i Universitetit të Stambollit**



Në platformën "albanica.al", e mirënjohur për publikimet "në linjë" të studimeve shqiptare, botohet artikulli "Hasan Tahsini, dijetari e patrioti që meriton një vend të veçantë në panteonin kombëtar të dijes" i akad. Rexhep Meidanit (në formatin shtypshkrim botuar më parë në revistën "Univers").

Artikulli përmban 17 f. dhe është i pajisur me signaturë si "dokument me identifikim digjital" (digital object identified) në <https://doi.org/10.59164/univers.v21i21.1161>

Këshillimi i artikullit të plotë, shqip e anglisht, në linkun e mëposhtëm:

<https://albanica.al/univers/article/view/1161/1141>

www.akad.gov.al

Interesim mbarëshqiptar për Vitin Kombëtar të Gjuhës dhe konferencën shkencore ndërkombëtare në Ditën e Gjuhës Shqipe, në përvjetorin e Kongresit të Manastirit



- <https://zhurnal.mk/atsh-konference-shkencore.../>
- <https://ata.gov.al/.../konference-shkencore.../>
- <https://www.panorama.com.al/viti-i-gjuhes-shqipe-e.../...>
- <https://www.botasot.al/viti-i-gjuhes-shqipe-e-kontributi.../>
- <https://www.tiranadiplomat.com/.../konference-shkencore.../>
- <https://gazetashqiptare.al/.../viti-gjuhes-shqipe-e.../>
- <https://www.kultplus.com/.../konference-shkencore.../>
- <https://frekuenca.net/.../35067-konference-shkencore...>
- <https://tradita.org/.../18-19-nentor-2024-konference.../>
- <https://www.gazetatema.net/.../festa-zyrtare-e-shqipes...>
- <https://www.voal.ch/viti-i-gjuhes.../multimedia/dossier/>
- <https://ina-online.net/atsh-konference-shkencore.../>
- <https://lajmpress.org/atsh-konference-shkencore.../>
- <https://www.tetovasot.com/.../atsh-konference-shkencore.../>
- <https://mia.mk/.../atsh-konferenc%C3%AB-shkencore-nd%C3...>

<https://aktuale.mk/konference-shkencore-nderkombetare.../>
<https://almakos.com/atsh-konference-shkencore.../>
<https://fax.al/.../atsh-konference-shkencore...>
<https://tvnews.mk/.../atsh-konference-shkencore.../>
<https://zyrtare.net/.../atsh-konference-shkencore.../>
<https://pressonline.al/.../atsh-konference-shkencore.../>
<https://tvkoha.tv/atsh-konference-shkencore.../>
<https://tetovaexpres.com/.../atsh-konference.../>
<https://koha.mk/atsh-konference-shkencore-nderkombetare.../>
<https://www.ora24.tv/atsh-konference-shkencore.../>
<https://lajme24.mk/konference-shkencore-nderkombetare.../>
<https://usalbanianmediagroup.com/festa-zyrtare-e-shqipes.../>
<https://www.mcntv.al/node/202418>

ATSH: Konferencë shkencore ndërkombëtare për gjuhën shqipe në nëntor në Manastir

Tiranë, 9 gusht - Akademia e Shkencave të Shqipërisë shpalli thirrjen për pjesëmarrje në konferencën shkencore ndërkombëtare “Zhvillimi i arsimit kombëtar dhe i gjuhës shqipe”, informon agjencia telegrafike shqiptare – ATSH.

“Thirrja bëhet për pjesëmarrje me kontribut shkencor. Propozimet mund të dërgohen drejtpërsëdrejti në adresën e komitetit shkencor-organizues ose në Akademinë e Shkencave, e cila do të mbështesë pjesëmarrësit në konferencën, e cila do të zhvillohet gjatë muajit nëntor, në mjediset e Muzeut të Alfabetit në Manastir”, bën të ditur ATSH.

Kjo konferencë mbahet në kuadër të “veprimtarive nderuese për përvjetorin e Kongresit historik të Manastirit dhe të festës zyrtare të shqipes në Maqedoninë e Veriut”.

Gjatë ditëve të veprimtarisë, Akademia e Shkencave do të paraqesë për herë të parë (në Tiranë) publikisht në mënyrë tërësore realizimin e projektit shkencor madhor për “Fjalorin e madh të shqipes”.

Viti 2024 në Shqipëri është shpallur “Vit i gjuhës shqipe”, ndërsa 22 nëntori, dita e fundit e Kongresit të Manastirit, është vendosur të shpallet festë zyrtare e shqipes, bën të ditur ATSH.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë është bashkorganizuese e veprimtarisë. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe Agjencia e Zbatimit të Dygjuhësisë, janë në rolin e mikpritësit dhe organizatorë kryesorë të saj, me pjesëmarrjen e disa universiteteve në Shqipëri e Maqedoni të Veriut.

Kongresi i Manastirit u mbajt nga 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908, me qëllim që të standardizohet alfabeti shqiptar ndërsa 22 nëntori shënohet si Dita e Alfabetit Shqiptar.

Banka Botërore, në raportin e saj të posabotuar, vlerëson si një prej arritjeve të Shqipërisë për përfshirjen në bashkëpunim me diasporës intelektuale themelimin e qendrës “NanoAlb”



- Në raport theksohet se “NanoAlb”, që vepron në nanoshkencë e nanoteknologji, e themeluar nga Akademia e Shkencave në vitin 2019, është një shembull i përfshirjes së intelektualëve shqiptarë jashtë vendit në projektet dhe nismat e saj shkencore prioritare -

- Nga një qendër lokale pioniere në fushën e saj, “NanoAlb” ka arritur tashmë të rrjetëzojë kërkimet e veta në shkallë ndërkombëtare, duke përfshirë në projektet shkencore jo vetëm vendet e rajonit të Ballkanit, por edhe Spanjën, Izraelin, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës -

- Banka Botërore e veçon njësinë “NanoAlb” si një nga argumentet bazë të rekomandimeve të saj, që Shqipëria nuk duhet të trembet nga punësimi i intelektualëve shqiptarë jashtë vendit: e rëndësishme është që ata të kthehen: profesionistët le të largohen, por nxitini të rikthehen -

- Lajmi i plotë në “[Scan.tv.al](https://www.scan.tv.al/)” në linkun:

<https://scantv.al/bindni-emigrantet-qe-te-rikthehen.../>

Dhe në Top News TV në linket:

<https://www.youtube.com/watch?v=xZfJgSbixRg>

<https://youtu.be/xZfJgSbixRg?si=ADDVe2xy84awaALw>

Shih edhe linkun e mëposhtëm:

<https://wallstreet.al/bindni-emigrantet-qe-te-rikthehen.../>

"NanoAlb" drejtohet që nga themelimi nga akad. Arben Merkoçi. Në Tiranë janë organizuar tre kongrese shkencore në fushën e nanoteknologjisë, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga e gjithë Bota, duke përfshirë nobelistë e të nominuar për çmimin "Nobel".



Sivjet "NanoAlb" përfundoi me sukses pesë projekte shkencore dhe në vjeshtë do të organizohet një kongres tjetër shkencor vjetor.

"NanoAlb" ka një rrjet bashkëpunëtorësh prej më shumë se 100 ekspertësh të fushës brenda dhe jashtë vendit.

- Grupet e punës të "NanoAlb" funksionojnë në mënyrë të organizuar edhe në Kosovë, Maqedoninë e Veriut e vende të tjera.

<https://www.google.com/.../bb-vlereson-krijimin-nanoalb.../>

"NanoAlb", the Regional Centre of Nanoscience and Nanotechnology next to the Academy of Sciences of Albania

- "NanoAlb", që është ngritur pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është tashmë qendër rajonale e nanoshkencës -

- One of the most significant achievements of "NanoAlb" is the cultural shift in how science is perceived and conducted. A shift is under way from "me" to "us": from the individual principal investigator to a team science approach, and from academic silos to market-oriented discoveries -

- Nga dokumenti i Bankës Botërore për njësinë "NanoAlb", hartuar nga Cristobal Garcia (Massachusetts Institute of Technology) dhe Edward Crawley (Ford Professor of Engineering at the Massachusetts Institute of Technology) -

- Artikulli i plotë, me titull "Accelerating innovation for development: how universities leverage knowledge exchange to boost economic growth in Middle-Income countries", gjendet në fund të këtij shenjimi -

Në vijim pjesa për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, që ka shërbyer si dokument bazë për raportin vjetor 2024 të World Bank për kërkimin shkencor dhe përfshirjen e diasporës intelektuale në vendin tonë:

This paper serves as a background paper to the World Development Report 2024: The Middle-Income Trap.

The findings, interpretations, and conclusions expressed in this paper are entirely those of the authors. They do not necessarily represent the views of the International Bank for Reconstruction and Development/World Bank and its affiliated organizations, or those of the Executive Directors of the World Bank or the governments they represent.

Collaborative Research Case Study: Albania

By implementing collaborative research, universities can play a key role in turning emigration into development. Diaspora can produce powerful innovation effects in origin countries by amplifying knowledge exchange, building a culture of collaboration that sustains innovation, leveraging migrant networks, and driving investments. Insufficient development of local innovation capabilities is a major reason for the middle-income trap (Paus 2017).

In Albania, actors in the innovation ecosystem are not only unprepared to bring innovation capabilities to maturity but also are overwhelmed dealing with high unemployment, a growing informal economy, widespread corruption, weak national infrastructure, powerful organized crime networks, and severe devastation of natural

resources (Albania-INSAT 2021; ILO 2020; Transparency International 2022; United States-CIA 2023; ENACT 2023; IMF 2022).



In addition to the lack of domestic resources and talented capital, a massive brain drain exacerbates the crisis. Albania's population is 2.8 million (UNFPA 2023), but it is estimated that up to 1.6 million Albanians emigrants live abroad (King and Gëdeshi 2020).



Education is a fundamental element to reverse this situation, but it is not sufficient. Albania was spending 3.1 percent of its GDP on education per year as of 2020 (World Bank 2020). Although the number of students enrolled in higher education has increased and surpassed 120,000 in 2023 (Albania INSAT 2023), the quality of Albanian universities is relatively low. None of the 30 main universities have met eligibility criteria to receive a rank in the main world university rankings (QS 2023; THE 2023). College students end up with the unpromising dilemma of finding a local, unstable job - likely with a low salary - or leaving the country.



Evidently, following a career as researcher and innovator does not seem feasible, nor is it encouraged. Now, in addition to education, Albania is integrating collaborative research to build innovation capabilities and leverage scientific diaspora.

For example, "NanoAlb" was created in 2019 by the Academy of Sciences of Albania as it restructured in response to Albanian government directives. The aim is to increase the quality of research in the region by promoting collaborations among various nanotechnology laboratories, encouraging synergies among industry-academia-government, and improving their visibility to attract new national and international projects. This initiative is supported by the Albanian scientific diaspora and various Albanian universities and research centers that have joined this collaborative network. Twenty-five interdisciplinary research groups are focused on developing promising discoveries to tackle national challenges, from electrochemical biosensors to nanotechnology methods for agriculture applications, and from nanodrug delivery systems to nanotechnology in textiles.

"NanoAlb" works as a virtual center and coordinates nanoscience and nanotechnology activities of multiple researchers at universities and research centers in

Albania, Kosovo, and North Macedonia, including groups from Israel, Italy, and Spain. A key component is the dissemination of knowledge and education activities of interest to future young generations of scientists. "NanoAlb" will offer courses at the master's degree level in nanotechnology and its application in health, pharma, environment, food, agriculture, safety, and security. "NanoAlb" has accomplished what many governments and institutions have failed to do: to build the foundations of a network that can sustain itself with limited help. "NanoAlb" has established a vibrant culture of collaboration among scientists by promoting scientific exchanges, sharing talent and resources to address the unmet needs of research projects and partnerships, building personal connections, and notifying participants about resources they have available and what they can contribute to others.



The World Bank

A generous progressive community of practice excels at peer mentoring. Researchers are leveraging their own network to build this collaborative extended network. Dr. D. Bello - a diaspora scientist - praised the work of "NanoAlb" and its

leaders: "It takes painstaking dedication, sacrifice, patriotism, and eternal optimism to build a structure like "NanoAlb". It requires constantly pulling strings from all directions - with government, foundations, colleagues, investors, and businesspeople - in order to hold the new web of collaborations. "NanoAlb" is the embryo of a future modern ecosystem of innovation in the region. And this makes me hopeful for my country".

Building this kind of modern network in middle-income countries represents intellectual architecture at its finest. Despite scarce resources, scientists have revitalized a strong network of people and built the infrastructure necessary to support the network. "NanoAlb's" director and coordinator, dr. Arben Merkoçi, revealed that nurturing a culture of collaboration requires persistence, effective and constant communication, and a tireless determination to ascertain needs, build capabilities, and overcome limitations. But most importantly, research is action. Researchers must change their mindsets: "Possibilities always exist. But you cannot stay in a kind of stand by just waiting. You need to explore whatever possibility exists and do something".

This proactive approach is extremely important for countries that have low resources. One of the most significant achievements of "NanoAlb" is the cultural shift in how science is perceived and conducted. A shift is under way from "me" to "us": from the individual principal investigator to a team science approach, and from academic silos to market-oriented discoveries.

Evidence shows that there is no universal understanding of what constitutes success for diaspora scientific network organizations (Butler et al. 2022), but there are basic outcomes included but not limited to: connections made, events held, visibility enhanced, positive feedback received, mobility facilitated, professional development supported, organizational growth, and information gathered. In all of these metrics, "NanoAlb" has exceeded expectations.

The Albanian case illustrates other relevant outcomes: local researchers identifying and unlocking existing resources; interdisciplinary research groups tackling national grand challenges; scientists leveraging synergies with industry; talented emigrants becoming role models; and students refusing emigration as the only alternative to advance their careers. As dr. Magdalena Cara, a local scientist working on improving methods for agriculture diagnostics, concluded: "I could see the hope in the eyes of the younger generation of people who believe that impactful research is possible even in places like Albania".

Centres of Research, Education, and Innovation Centres of research, education, and innovation are research communities that bring together scholars, experts from industry, government, and other groups. These participants advance the pace of knowledge exchange and the production of directly implementable and impactful

solutions that address significant issues in industry, economic development, and society. The practice calls for recruiting representatives of all the stakeholders early, so that the definition of the societal issue can be sharpened, solutions can be facilitated, and outcomes can be rapidly exchanged and moved toward applications. Universities and their researchers will make discoveries that are more effective instruments of knowledge exchange and innovation, by empowering larger scale integrated centres producing impactful solutions that address significant community needs and can be directly implemented. The development of a research, education, and innovation community, the educational efforts, and the multidirectional exchange of people, practices, and ideas all help prepare a cadre of future leaders. Such industry-university collaboration can be a major force on economic development (Lécuyer 2005). The combination of universities plus industry provides a platform for convening a wider group. The roles of universities, industry, and government increasingly intertwine (Etzkowitz 2008). Key actions for implementing centres of research, education, and innovation include the following:

- Identifying the key issues to address, motivated by needs of society and overarching “grand challenge” goals;
- Building an integrated community of university researchers and students, industry, government, regulators, public interest groups, and others, working together in close partnership;
- Developing outcomes at an accelerated pace, and testing them in realistic environments;
- Structuring an effective and well-defined organization to lead projects, manage interactions, and attract resources.

Success for centres of research, education, and innovation entails more than productivity improvements at the firm level. The benefits of knowledge exchange through the centers can shape the innovation ecosystem. The emphasis is on influencing an innovation culture, propelling the capability in the community to collaborate, and forming a new generation of change makers.

<https://www.worldbank.org/en/search?q=Nanoalb>

<https://thedocs.worldbank.org/.../Accelerating-Innovation...>

<https://www.facebook.com/share/8uweckBFDTukxAfY/?mibextid=oFDknk>

“Bindni emigrantët që të rikthehen!”



“Bindni emigrantët që të rikthehen!” – Banka Botërore: Potencial për zhvillimin...

- Krijimi i njësisë "NanoAlb" nga Akademia e Shkencave në vitin 2019 bëri që pranë saj të funksiononte një qendër virtuale rajonale për të koordinuar kërkimet në këtë fushë -

- "Wal-street-i shqiptar" vlerëson raportin vjetor të Bankës Botërore dhe punën e suksesshme të Akademisë së Shkencave për përfshirjen në bashkëpunim të diasporës intelektuale -

Banka Botërore: Potencial për zhvillimin e teknologjisë në vend

Profesionistët le të largohen, por nxitini më pas që të rikthehen, me qëllim që dijet e marra nga shtetet e huaja t'i zbatojnë në projekte për zhvillimin e teknologjisë në Shqipëri. Kështu është shprehur Banka Botërore në një raport të publikuar për vendet

me të ardhura mesatare.

Lëvizja e ideve, së bashku me mallrat, shërbimet, kapitalin dhe njerëzit, janë kritike për zhvillimin dhe përhapjen e teknologjisë. Sipas Bankës Botërore, vendet me të ardhura mesatare si Shqipëria, nuk duhet të kufizojnë lëvizjen e emigrantëve, pasi emigrimi i tyre mund të jetë një mundësi për vendin e origjinës dhe jo një humbje.

Shkalla në të cilën kjo mund të ndodhë varet nga sa shumë emigrantët mbeten të lidhur me Shqipërinë, si dhe aftësinë e emigrantëve për të grumbulluar njohuri rreth proceseve dhe teknologjive moderne të prodhimit nga vendet ku kanë emigruar. Banka Botërore sugjeron që vendi ynë të krijojë një mjedis të favorshëm për transferimin e njohurive të diasporës duke rregulluar kushte të tilla si qëndrueshmërinë politike, cilësinë e institucioneve dhe një klimë të favorshme investimi. Përveç kësaj, vendet e origjinës duhet të shfrytëzojnë në mënyrë efikase të ardhurat e emigrantëve për të siguruar rritjen ekonomike duke mundësuar një rrjedhë fitimprurëse të remitancave.

Në raportin e publikuar, Banka Botërore ka përmendur edhe një prej arritjeve të Shqipërisë për angazhimin dhe nxitjen e bashkëpunimit me diasporën. Ajo vlerëson krijimin e "NanoAlb" nga Akademia e Shkencave në vitin 2019, një qendër virtuale për të koordinuar kërkimet e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë në institucionet e vendosura në Shqipëri, si dhe në Izrael, Itali, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Spanjë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

<https://wallstreet.al/bindni-emigrantet-qe-te-rikthehen.../>

<https://youtu.be/zeN2LMoZPdE?si=jpRUYOIGAcC28yx0>

Në raportin e Bankës Botërore pozitivisht vlerësohet fakti që në vitin 2019 Akademia e Shkencave krijoi njësinë "NanoAlb", një qendër virtuale për të koordinuar kërkimet e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë



BB vlerëson krijimin "NanoAlb" në bashkëpunim me diasporën intelektuale

Banka Botërore sugjeron investime në arsim, teknologji dhe kapitalin njerëzor për vendet me të ardhura të mesme, mes të cilave edhe Shqipëria. Në raport thuhet se ndërhyrjet në politikën fiskale mund të rikthejnë emigrantët në vendet e origjinës, përmes reduktimit të normave tatimore për punonjësit në fushat e kërkimit dhe zhvillimit. Kjo do të ndikonte në frenimin e largimit të specialistëve në këto fusha, dhe në afatgjatë do të ndihmonte edhe në investimet teknologjike.

Në raport thuhet se që kompanitë të jenë inovative me teknologji të reja, kanë nevojë për punëtorë të kualifikuar, inxhinierë, shkencëtarë, menaxherë dhe profesionistëve të tjerë shumë të aftë.

Vendet me të ardhurat të mesme sipas Bankës Botërore duhet të jenë relativisht të hapura ndaj ekonomisë dhe ideve nga jashtë.

Sipa Bankës Botërore qeveritë duhet të miratojnë politika që do t'i mundësojnë ekonomisë të shpërndajë talentet dhe kapitalin njerëzor në mënyrë më efikase - në veçanti, duke hapur mundësitë e arsimit, punësimit dhe biznesit për të gjithë ata që kanë talent dhe shfaqin aftësi të fituara.

Për Shqipërinë vlerësohet në raport pozitivisht fakti që në vitin 2019 Akademia e Shkencave krijoi njësinë "NanoAlb", një qendër virtuale për të koordinuar kërkimet e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë në institucionet e vendosura në Shqipëri, si dhe në Izrael, Itali, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Spanjë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

https://www.worldbank.org/en/search?q=NanoAlb&_gl=1*_haf36r*_gcl_au*M Tc1ODA0ODQxMi4xNzIzMzIxNDk1

<https://www.worldbank.org/en/search?q=Nanoalb>

<https://thedocs.worldbank.org/.../Accelerating-Innovation...>

<https://albuktv.com/bb-vlereson-krijimin-nanoalb-ne.../>

<https://wallstreet.al/bindni-emigrantet-qe-te-rikthehen.../>

<https://youtu.be/zeN2LMoZPdE?si=XKxhtQQyQZ5QEJgl>

<https://gazetasi.al/si-mundet-te-perfitoje-shqiperia-nga.../>

<https://ata.gov.al/.../bb-vlereson-krijimin-nanoalb-ne.../>

<https://frekuenca.net/.../35401-bb-vlereson-krijimin...>

<https://scantv.al/bindni-emigrantet-qe-te-rikthehen.../>

<https://youtu.be/xZfJgSbixRg?si=XK42pA89dulBjl0r>

Botohet në vijim dokumenti bazë në të cilin u mbështet vlerësimi i Bankës Botërore për njësinë “NanoAlb” të ngritur pranë Akademisë së Shkencave si një model bashkëpunimi me diasporën intelektuale shqiptare

Collaborative Research Case Study: Albania

By implementing collaborative research, universities can play a key role in turning emigration into development. Diaspora can produce powerful innovation effects in origin countries by amplifying knowledge exchange, building a culture of collaboration that sustains innovation, leveraging migrant networks, and driving investments.

Insufficient development of local innovation capabilities is a major reason for the middle-income trap (Paus 2017). In Albania, actors in the innovation ecosystem are not only unprepared to bring innovation capabilities to maturity but also are overwhelmed dealing with high unemployment, a growing informal economy, widespread corruption, weak national infrastructure, powerful organized crime networks, and severe devastation of natural resources (Albania-INSAT 2021; ILO 2020; Transparency International 2022; United States-CIA 2023; ENACT 2023; IMF 2022). In addition to the lack of domestic resources and talented capital, a massive brain drain exacerbates the crisis. Albania’s population is 2.8 million (UNFPA 2023), but it is estimated that up to 1.6 million Albanians emigrants live abroad (King and Gëdeshi 2020).

Education is a fundamental element to reverse this situation, but it is not sufficient. Albania was spending 3.1 percent of its GDP on education per year as of 2020 (World Bank 2020). Although the number of students enrolled in higher education has increased and surpassed 120,000 in 2023 (Albania-INSAT 2023), the quality of Albanian universities is relatively low. None of the 30 main universities have met eligibility criteria to receive a rank in the main world university rankings (QS 2023; THE 2023). College students end up with the unpromising dilemma of finding a local, unstable job—likely with a low salary—or leaving the country. Evidently, following a career as researcher and innovator does not seem feasible, nor is it encouraged. Now, in addition to education, Albania is integrating collaborative research to build innovation capabilities and leverage scientific diaspora. For example, **NanoAlb** was created in 2019 by the Academy of Sciences of Albania as it restructured in response to Albanian government directives.

Titulli si në origjinal:

"Përshpejtimi i inovacionit për zhvillim: si e përdorin universitetet shkëmbimin e njohurive për të nxitur rritjen ekonomike në vendet me të ardhura mesatare"

Kush janë autorët:

Cristobal Garcia është sipërmarrës sistemesh dhe bashkëpunëtor në Institutin e Teknologjisë në Massachusetts (crigar@mit.edu). Edward Crawley është profesor i inxhinierisë së kompanisë "Ford" në Institutin e Teknologjisë në Massachusetts (crawley@mit.edu).

- Ky studim shërben si një dokument bazë për “Raportin e zhvillimit botëror 2024: kurthi i të ardhurave të mesme” (shenjim në origjinal) -

- Shqipëria po integron kërkimin bashkëpunues për të ndërtuar aftësi inovative dhe për të nxitur diasporën shkencore: për shembull, "NanoAlb" -

- "NanoAlb" ka arritur atë që shumë qeveri dhe institucione nuk kanë arritur ta bëjnë: të ndërtojë themelet e një rrjeti që mund të mbajë veten me një ndihmë të

kufizuar: "NanoAlb" ka krijuar një kulturë të gjallë bashkëpunimi midis shkencëtarëve duke promovuar shkëmbimet shkencore, duke ndarë talentin dhe burimet për të adresuar nevojat e paplotësuara të projekteve kërkimore dhe partneriteteve, duke krijuar lidhje personale dhe duke informuar pjesëmarrësit për burimet që kanë në dispozicion dhe çfarë mund të kontribuojnë për të tjerët; një komunitet bujar progresiv i praktikës, që shkëlqen në mentorimin e kolegëve -

- Një nga arritjet më domethënëse të "NanoAlb" është ndryshimi kulturor në mënyrën se si perceptohet dhe drejtohet shkenca; një ndryshim është duke u bërë nga "unë" tek "ne": nga kërkuesi kryesor individual në një qasje të shkencës në grup dhe nga mjediset akademike në zbulimet e orientuara nga tregu -

- "NanoAlb" është embrioni i një ekosistemi të ardhshëm modern të inovacionit në rajon -

(Përkthimi shqip nga prof. Kledi Xhaxhiu)



- Në vijim publikohet vetëm pjesa për njësinë "NanoAlb", Akademinë e Shkencave dhe Shqipërinë; si dhe përfundimet e rekomandimet. Artikulli i plotë do të ribotohet, duke përfshirë pjesën teorike, rastet e tjera studimore dhe bibliografinë, në periodikun shkencor të Akademisë së Shkencave AJNTS -

Për të interesuarit, studimi mund të shfletohet anglisht në linkun:

<https://thedocs.worldbank.org/.../Accelerating-Innovation...>

Abstrakt:

Vendet me të ardhura mesatare mund t'i përmirësojnë rezultatet e inovacionit dhe të përshpejtojnë zhvillimin e tyre ekonomik nëpërmjet universiteteve, duke nxitur shkëmbimin e njohurive. Universitetet mund t'i shfrytëzojnë burimet e ekosistemit të inovacionit dhe kuptimin e thelluar të përmbajtjes së tyre në kuadër të nevojave

vendore. Shkëmbimi i njohurive bëhet nëpërmjet lëvizjes dydrejtimëshe të njerëzve, aftësive dhe ideve përmjet kufirit poroz midis universitetit dhe partnerëve. Universitetet mund t'i përshtasin praktikat efektive të arsimit, kërkimit dhe katalizimit të inovacionit për të avancuar aftësitë e ekosistemit në përmbysjen e kushteve negative të vendeve me të ardhura mesatare dhe për t'i çuar shoqëritë e tyre drejt prosperitetit të qëndrueshëm.

Ky hulumtim tregon se si vendet me të ardhura mesatare mund të transformojnë sistemet e arsimit të lartë duke inkurajuar bashkëpunimin në të gjithë ekosistemin e inovacionit, duke vendosur objektiva të të mësuarit bazuar në kontributin e palëve të interesuara, duke vendosur elemente kurrikulare të integruara dhe duke shfrytëzuar praktikuesit. Nëpërmjet zbatimit të kërkimeve bashkëpunuese, universitetet mund të shfrytëzojnë idetë dhe teknologjitë e reja për t'a kthyer emigracionin në zhvillim dhe të nxisin investimet. Universitetet mund të rrisin produktivitetin duke ndërtuar komunitete të kërkimit dhe duke përmirësuar inovacionin e proceseve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Universitetet mund të krijojnë mundësi për sipërmarrje si për komunitetin universitar, ashtu edhe për atë në zonat urbane. Nga përshtatja dhe zbatimi i këtyre praktikave efektive, universitetet në vendet me të ardhura mesatare mund të forcojnë aleancat, të shumëfishojnë inovacionin dhe të nxisin zhvillimin ekonomik.

Fjalët kyçe:

Universitete, zhvillim ekonomik, shkëmbim njohurish, arsim, inovacion katalizues, vende me të ardhura mesatare, kurrikulë e integruar, kërkime bashkëpunuese, sipërmarrje, qendra, ekosistem inovativ, bashkëpunim.

I.

Rast studimor mbi kërkimin bashkëpunues: Shqipëria

Duke zbatuar kërkimet bashkëpunuese, universitetet mund të luajnë një rol kyç në shndërrimin e emigracionit në zhvillim. Diaspora mund të prodhojë efekte të fuqishme inovacioni në vendet e origjinës duke përforcuar shkëmbimin e njohurive, duke ndërtuar një kulturë bashkëpunimi që mbështet inovacionin, duke shfrytëzuar rrjetet e migrantëve dhe duke nxitur investimet.

Zhvillimi i pamjaftueshëm i aftësive vendore të inovacionit është një arsye kryesore për "kurthin" e të ardhurave mesatare (Paus 2017). Në Shqipëri, aktorët në ekosistemin e inovacionit nuk janë vetëm të papërgatitur për të shpënë aftësitë e inovacionit në pjekuri, por gjithashtu janë të mbingarkuar, duke u përballur me papunësinë e lartë, ekonominë informale në rritje, korrupsionin e përhapur, infrastrukturën e dobët kombëtare, rrjetet e fuqishme të krimit të organizuar dhe shkatërrimin e rëndë të burimeve natyrore. (Shqipëri-INSAT 2021; ILO 2020; Transparency International 2022; Shtetet e Bashkuara-CIA 2023; ENACT 2023; FMN 2022). Përveç mungesës së burimeve vendase dhe kapitalit të talentuar, ikja masive e

trurit e ka përkeqësuar krizën. Popullsia e Shqipërisë është 2.8 milionë banorë (UNFPA 2023), por vlerësohet se deri në 1.6 milionë shqiptarë emigrantë jetojnë jashtë vendit (King dhe Gëdeshi 2020).

Arsimi është një element themelor që mund t'a ndryshojë këtë gjendje, por nuk është i mjaftueshëm. Që nga viti 2020 Shqipëria shpenzon 3.1 për qind të PBB-së së saj për arsimin në vit (Banka Botërore 2020). Megjithëse numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë është rritur, duke kaluar 120,000 në vitin 2023 (Albania-INSAT 2023), cilësia e universiteteve shqiptare është relativisht e ulët. Asnjë nga 30 universitetet kryesore nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, për të siguruar një vend në renditjen kryesore të universiteteve botërore (QS 2023; THE 2023). Studentët e kolegjit përfundojnë me dilemën jopremtuese për të gjetur një punë në vend, të paqëndrueshme - e me gjasë me një pagë të ulët - ose të largohen nga vendi. Me sa duket, ndjekja e një karriere si studiues dhe novator nuk duket e realizueshme dhe as nuk inkurajohet. Aktualisht, përveç arsimit, Shqipëria po integron kërkimin bashkëpunues për të ndërtuar aftësi inovative dhe për të nxitur diasporën shkencore. Për shembull, "NanoAlb" u krijua në vitin 2019 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, pasi ajo u ristrukturua në përgjigje të direktivave të qeverisë shqiptare.

Synimi i kësaj qendre kërkimore është të rritet cilësia e kërkimit në rajon duke promovuar bashkëpunimet ndërmjet laboratorëve të ndryshëm të nanoteknologjisë, duke inkurajuar sinergjitë midis industrisë, Akademisë e Qeverisë dhe duke përmirësuar vizibilitetin e tij për të tërhequr projekte të reja kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo nismë mbështetet nga diaspora shkencore shqiptare dhe universitete e qendra kërkimore të ndryshme shqiptare që i janë bashkuar këtij rrjeti bashkëpunues.

Njëzet e pesë grupe kërkimore ndërdisiplinore janë të përqendruar në zhvillimin e zbulimeve premtuese për të trajtuar sfidat kombëtare, nga biosensorët elektrokimikë tek metodat nanoteknologjike për aplikimet në bujqësi; dhe nga sistemet e shpërndarjes së nanobarnave tek nanoteknologjia në tekstile.

"NanoAlb" punon si një qendër virtuale dhe koordinon aktivitetet e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë, të studiuesve të shumtë në universitete dhe qendra kërkimore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë grupe të asociuar nga Izraeli, Italia dhe Spanja. Një komponent kyç në strategjinë e kësaj qendre kërkimore është shpërndarja e njohurive dhe aktiviteteve arsimore me interes për brezat e rinj të shkencëtarëve të ardhshëm.

"NanoAlb" ofron kurse të nivelit master në nanoteknologji dhe për aplikimet e saj në shëndetësi, farmaci, mjedis, në sigurinë ushqimore, bujqësi etj.

"NanoAlb" ka arritur atë që shumë qeveri dhe institucione nuk kanë arritur ta bëjnë: të ndërtojë themelet e një rrjeti që mund të mbajë veten me një ndihmë të

kufizuar. "NanoAlb" ka krijuar një kulturë të gjallë bashkëpunimi midis shkencëtarëve duke promovuar shkëmbimet shkencore, duke ndarë talentin dhe burimet për të adresuar nevojat e paplotësuara të projekteve kërkimore dhe partneriteteve, duke krijuar lidhje personale dhe duke informuar pjesëmarrësit për burimet që kanë në dispozicion dhe çfarë mund të kontribuojnë për të tjerët. Një komunitet bujar progresiv i praktikës që shkëlqen në mentorimin e kolegëve.



Kërkuesit shkencorë të kësaj qendre po përdorin njohjet e tyre për të ndërtuar këtë rrjet të zgjeruar bashkëpunues. Dr. Dhimitri Bello, një shkencëtar i specializuar për diasporën, vlerësoi punën e "NanoAlb" dhe drejtuesve të tij: "Duhet përkushtim i mundimshëm, sakrificë, patriotizëm dhe optimizëm i përjetshëm për të ndërtuar një strukturë si "NanoAlb", që kërkon tërheqje të vazhdueshme nga të gjitha drejtimet - qeveria, fondacionet, kolegët, investitorët dhe biznesmenët - në mënyrë që të mbajë rrjetin e ri të bashkëpunimeve. "NanoAlb" është embrioni i një ekosistemi të ardhshëm modern të inovacionit në rajon. Dhe kjo më bën të shpresoj për vendin tim". Ndërtimi i këtij lloji të rrjetit modern në vendet me të ardhura mesatare përfaqëson arkitekturën intelektuale në shkallën e saj më lartë. Pavarësisht burimeve të pakta, kërkuesit shkencorë të "NanoAlb" kanë rigjallëruar një rrjet të fortë njerëzish dhe kanë ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur rrjetin.

Drejtori dhe koordinatori i njesisë "NanoAlb" akademik Arben Merkoçi na tha se kultivimi i një kulture bashkëpunimi kërkon këmbëngulje, komunikim efektiv e të vazhdueshëm dhe një vendosmëri të palodhshme për konstatimin e nevojave, ndërtimin e aftësive dhe kapërcimin e kufizimeve. Por më e rëndësishmja, kërkimi është veprim. Studiuesit duhet ta ndryshojnë mentalitetin e tyre:

“Mundësitë ekzistojnë gjithmonë. Nuk mund të qëndrohet në një lloj gjendje vetëm duke pritur. Duhet shfytëzimi i çdo lloj mundësie që ekziston për të bërë diçka”. Kjo qasje proaktive është jashtëzakonisht e rëndësishme për vendet që kanë burime të ulëta”.



Një nga arritjet më domethënëse të "NanoAlb" është ndryshimi kulturor në mënyrën se si perceptohet dhe drejtohet shkenca. Një ndryshim është duke u bërë nga “unë” tek “ne”: nga kërkuesi kryesor individual në një qasje të shkencës në grup dhe nga mjediset akademike në zbulimet e orientuara nga tregu. Provat tregojnë se nuk ka një kuptim universal të asaj që përbën sukses për organizatat e rrjetit shkencor të diasporës (Butler et al. 2022), por ka rezultate bazë të përfshira, por pa u kufizuar në: lidhjet e krijuara, ngjarjet e mbajtura, vizibilitetin e rritur, reagimet pozitive të marra, lëvizshmërinë e lehtësuar, mbështetjen në zhvillimin profesional, rritjen organizative dhe informacionin e mbledhur. Në të gjitha këto matje, "NanoAlb" i ka tejkaluar pritshmëritë.

Rasti shqiptar ilustron rezultate të tjera domethënëse: studiuesit vendës që identifikojnë dhe zhbllkojnë burimet ekzistuese; grupet kërkimore ndërdisiplinore që i trajtojnë sfidat e mëdha kombëtare; shkencëtarët që përdorin sinergjitë me industrinë; emigrantët e talentuar duke u bërë shembuj; dhe studentët që refuzojnë emigracionin si alternativë të vetme për të avancuar karrierën e tyre. Dr. Magdalena Cara, një studiuese vendëse që punon në përmirësimin e metodave për diagnostikimin e bujqësisë pohoi: "Unë munda ta shoh shpresën në sytë e brezit të ri të njerëzve që besojnë se kërkimi me ndikim është i mundur edhe në vende si Shqipëria."

II.

Qendrat e kërkimit, edukimit dhe inovacionit janë komunitete kërkimore që bashkojnë studiues, ekspertë nga industria, qeveria dhe grupe të tjera. Këta pjesëmarrës avancojnë ritmin e shkëmbimit të njohurive dhe gjetjen e zgjidhjeve drejtpërdrejt të zbatueshme dhe me ndikim, që trajtojnë çështje të rëndësishme në industri, zhvillimin ekonomik dhe shoqëri.



Praktika kërkon rekrutimin e hershëm të përfaqësuesve të të gjithë palëve të interesuara, në mënyrë që përkufizimi i çështjes shoqërore të mund të mprehet, zgjidhjet të lehtësohen dhe rezultatet të shkëmbehen shpejt dhe të orientohen drejt aplikimeve. Universitetet dhe studiuesit e tyre do të bëjnë zbulime që janë instrumente më efektive të shkëmbimit të njohurive dhe inovacionit, duke fuqizuar qendra të integruara në shkallë më të madhe, që prodhojnë zgjidhje me ndikim, e që adresojnë nevojat të rëndësishme të komunitetit që mund të gjenë zbatim të drejtpërdrejt.

Zhvillimi i një komuniteti kërkimor, edukimi dhe inovacioni, përpjekjet arsimore dhe shkëmbimi në shumë drejtime i njerëzve, praktikave dhe ideve, ndihmojnë në përgatitjen e një kuadri udhëheqësish të ardhshëm. Një bashkëpunim i tillë industri-universitet mund të jetë një forcë kryesore në zhvillimin ekonomik (Lécuyer 2005). Kombinimi i universiteteve dhe industrisë ofron një platformë për mbledhjen e një grupi më të gjerë, ku rolet e universiteteve, industrisë dhe qeverisë ndërthuren gjithnjë e më shumë (Etzkowitz 2008).

III.

Veprimet kyç për zbatimin e qendrave të kërkimit, edukimit dhe inovacionit përmbledhen si vijon:

- Identifikimi i çështjeve kyçe për t'u adresuar, të motivuara nga nevojat e

shoqërisë dhe qëllimet gjithëpërfshirëse të “sfidës së madhe”;

- Ndërtimi i një komuniteti të integruar të studiuesve dhe studentëve të universitetit, industrisë, qeverisë, rregullatorëve, grupeve të interesit publik e të tjerëve, duke punuar së bashku në partneritet të ngushtë;

- Zhvillimi i rezultateve me një ritëm të përshpejtuar dhe testimi i tyre në mjedise realiste;

- Strukturimi i një organizate efektive dhe të mirëpërcaktuar për udhëheqjen e projekteve, menaxhimin e ndërveprimeve dhe tërheqjen e burimeve.

Suksesi për qendrat e kërkimit, edukimit dhe inovacionit kërkon më shumë sesa përmirësime të produktivitetit në nivel kompanie. Përfitimet e shkëmbimit të njohurive përmes qendrave mund të formësojnë ekosistemin e inovacionit. Theksi vihet në ndikimin e një kulture inovacioni, nxitjen e aftësisë në komunitet për të bashkëpunuar dhe formimin e një brezi të ri të krijuesve të ndryshimeve.

Profesor Albert Hafner, bashkëdrejtues i ekspeditës arkeologjike shqiptaro-zvicerane në vendbanimin palafit neolitik të Linit, flet për "News 24 TV"



- Lini, vendbanimi më i lashtë liqenor në Europë, i krahasueshëm me një sit liqenor të mirëstudiuar në Zvicër, por dymijë vjet më i hershëm se ai -
- Analizat përmes rrathëve të trungjeve të pemëve janë të sakta si orët zvicerane -
- Jeta në vendbanimin e Linit është dy mijë vjet më e hershme se në një sit liqenor në Zvicër. Ka zgjatur nga tetë deri në gjashtë mijë vjet përpara -
- Planimetria e vendbanimit shtrihet në liqen dhe në tokë, jetesa bazohej në peshkimin dhe gjuetinë, por në Lin shfaqen fillimet e bujqësisë -
- Nisur nga përmasat e rrethimit të sigurisë, vendbanimi mund të ketë pasur deri 400 banorë -
- Priten analiza plotësuese nga Berna dhe Oksfordi -
- Prof. Albert Hafner së shpejti në një ligjëratë të hapur në Akademinë e Shkencave, si i ftuar i veçantë i saj -

[#ashsh](#)

[#institutiiarkeologjise](#)

[#enciklopediashqiptare](#)

[#vendbanimiinit](#)

[#institutetealbanologjise](#)

[#alfredhafner](#)

[#News24](#)

Sipas arkeologut zviceran Albert Hafner, sitet si ai i Linit i ruajnë mirë materialet organike. Një sit i ngjashëm në Zvicër është trashëgimi nën mbrojtjen e UNESCO-s.

Këtu pa pasur jetë të pandërprerë për 2 mijë vite, në periudhën nga 8 mijë deri në 6 mijë vjet më parë. Gardhi mbrojtës që është gjetur në Lin shenjon fillimin e agrikulturës. Gjetjet arkeologjike sesi jetonin banorët e hershëm të Linit dëshmojnë se jetesa bazohej në gjuetinë dhe peshkimin, por pjesa më e rëndësishme e vendbanimit gjendet në tokë, shenjë e lindjes së bujqësisë. Nga përmasat e gardhit mund të supozohet se kishte rreth 400 banorë. Një pjesë të lëndës arkeologjike mund ta datojmë e shpjegojmë duke bërë krahasime me gjetjet e studiuara në sitin liqenor në Zvicër. Po punohet edhe me deondrokronologji, me rrathët e trungjeve të pemëve, që ka saktësinë e orëve zvicerane.

Arkeologu zviceran rekomandon që të mos inkurajohet turizëm masiv në sitin e Linit: më mirë të bëhet i njohur në mënyrë virtuale.

Bashkëdrejtuesi shqiptar Adrian Anastasi, arkeolog, shpjegon se kërkimet kanë nisur dhjetë vjet më parë dhe se gjetjet ia rrisin rëndësinë gjithë liqenit të Ohrit. Po dokumentohet planimetria e sitit, priten të reja nga analizat në Oksford e Bernë. Të dhënat e këtij viti flasin për një shtrirje të sitit në 6 hektarë. Analizat bëhen me radiokarbon, me mundësi shmangieje jo më shumë se 200-vjeçare.

Arkeologu Ilir Gjipali, pjesëtar i ekspeditës, shpjegon se gjetjet e qeramikës janë 8-mijëvjeçare. Gjetjet janë enë e kupa të vogla, që kanë parete të holla e të lustruara. Qeramika daton 5800 vite para erës sonë.

Intervista e realizua nga gazetarja Fatmira Nikolli.

Ndiqui të plotë bashkëbisedimin në linkun:

https://www.youtube.com/watch?v=EWPmlFAQN_g

Më 19 gusht 2024 do të çelet në Muzeun "Marubi" ekspozita "Vëllezërit Kodheli dhe Kolë Idromeno - Rilindja në artin pamor shqiptar" e kuruar nga Luçjan Bedeni


- Ekspozita është realizuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Muzeut "Marubi" dhe Institutit të Antropologjisë për digjitalizimin, restaurimin, konservimin dhe ekspozimin e koleksioneve dhe mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit -



Kolë Arsen Idromeno (15 gusht 1860 - 12 dhjetor 1939) rrjedh prej një familjeje të ardhur nga Parga e Greqisë e të vendosur në Shkodër. Mësimet e para të artit i mori në studion e Pietro Marubbi-t, gjë që e vuri në kontakt me mediumin më të ri të kohës, fotografinë. Në moshën 16-vjeçare, më 1875, ai shkon në Venecia, ku kalon një periudhë të shkurtër studimi në Akademinë e Arteve të Bukura e më pas pranë studios së një artisti venecian. Pas kësaj përvoje, më 1878 ai kthehet në Shkodër, ku shfaq interesat e dhuntitë e tij në disa fusha.

U bë i njohur për projektet arkitektonike të një sërë ndërtesash publike e private në Shkodër si Kafja e Madhe, Banka Kombëtare, disa shtëpi në dy rrugët kryesore të qytetit. Arkitektura që propozon ai sjell disa tipare perëndimore kundrejt arkitekturës orientale që kishte depërtuar ndër shekuj.

Njihet edhe si pionier i pikturës shqiptare duke krijuar një sërë veprash të rëndësishme për historinë e saj. Më 1884 është i dyti që hap studion e tij fotografike të quajtur "Dritëshkroja e Kolës".



Më 1.9.1912 shfaq për herë të parë në Shkodër e Shqipëri një film pas një kontrate të nënshkruar me agjencinë austriake të filmit "Stauber".

Fondi i tij fotografik numëron 1300 negativë në xham në Institutin e Antropologjisë të Akademisë së Shkencave në Tiranë dhe rreth 100 në Muzeun "Marubi".

Në vazhdimësi të përgatitjes për ekspozitën "Vëllezërit Kodheli dhe Kolë Idromeno - Rilindja në artin pamor shqiptar", e kuruar nga Luçjan Bedeni, e cila do të hapet në Muzeun "Marubi" më 19 gusht 2024, ju ftojmë të na ndiqni në rubrikën tashmë

të njoftuar, e cila do të japë fakte interesante mbi autorët e ekspozitës.



Çmimi "Olcinium" i panairit veror të librit, që organizohet në Ulqin, për studimin monografik iu dha librit "Baladë dritash për Zef Zorbën" të Viola Isufajt, botim i Akademisë së Shkencave (2023)




Në ditën e dytë të panairit tashmë tradicional veror të librit, që organizohet gjatë gushtit në Ulqin, juria e ngritur nga Instituti i Librit e Promocionit në Tiranë dhe autoritetet e qeverisjes vendore të qytetit bregdetar në Mal të Zi për këtë ngjarje kulturore, shpalli fitues të çmimit të panairit studimin monografik të Viola Isufajt "Baladë dritash për Zef Zorbën", botim i Akademisë së Shkencave (2023).

Studimi ndriçon individualitetin krijues të Zef Zorbës, i cili shkroi poezi "jashtë disiplinës", në stilin e hermetistëve, pa ndonjë shpresë se do t'i shihte të botuara për së gjalli. Është cilësuar si "poet i letërsisë së sirtareve".

Studiuesja Viola Isufaj e ka vlerësuar kërkimin e saj shkencor një punë të mundimshme drejt një bote thujtë të panjohur për lexuesin shqiptar, botë që vjen

përmes kësaj monografie.

Recensues të librit janë Ardian Ndreca (anëtar i jashtëm i ASHSH) dhe prof. Bashkim Kuçuku. U përrua si botim i ri në ditët e panairit të librit akademik e shkencor të organizuar në muajin prill nga Akademia e Shkencave dhe ASHAK.



Panairi i Ulqinit është tashmë ngjarje me rëndësi për librin në shkallë rajonale. Rreth 50 botues nga Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Serbia, Maqedonia e Veriut e Bosnje-Hercegovina kanë paraqitur botimet e tyre në stendat e panairit.

Akademia e Shkencave është pjesëmarrëse dhe periodikisht edhe bashkorganizuese e këtij panairi, pritjet e të cilit janë letërsia artistike, libri studimor, përthimet, botimet enciklopedike.

<https://gazetadielli.com/balade-dritash-per-zorben/>

<https://albanian.cri.cn/.../ARTIOlQtqB2zGHPE24xTRnSB24081...>


<https://www.kultplus.com/.../ndahen-cmimet-e-panairit-te.../>

<https://abnase.com/ulcinj-book-fair-closes-with-awarding.../>

<https://ata.gov.al/.../ndahen-cmimet-e-panairit-te.../...>
<https://kohajone.com/.../panairi-i-librit-ne-ulqin.../>
<https://www.oranews.tv/.../ndahen-cmimet-e-panairit-te...>
<https://frekuenca.net/.../36168-ndahen-cmimet-e-panairit...>
<https://www.gazetatema.net/.../ndahen-cmimet-e-panairit...>
<https://sot.com.al/.../panairi-i-librit-ne-ulqin-alda.../>
<https://observerkult.com/ndahen-cmimet-e-panairit-te.../>
<https://www.koha.net/.../panairi-i-librit-ne-ulqin-mbyll...>
<https://www.facebook.com/share/p/nxq8BGM8VqU8e5sx/?mibextid=oFDknk>

Sot ditëlindja jubilarë e akademikut Rexhep Meidani

Urim i Kryesisë së Akademisë së Shkencave



Në 80-vjetorin e lindjes, në jubileun e një jete të mbushur me veprimtari intensive e të pandërprerë shkencore dhe qytetare; Kryesia e Akademisë së Shkencave i uron akademikut Rexhep Meidani, anëtar i Asamblesë së saj prej më shumë se dy dekadash; figurë e shquar e shkencës në Shqipëri, përfaqësues referencial i brezit të fizikanëve që u formuan në universitete perëndimore dhe modernizuan programet, mësimdhënien e përgjithësisht jetën universitare në Shqipëri në vitet 1980, duke reformuar e duke i dhënë arsimit të lartë karakter bashkëkohor; me kontribute të njohura e të mirëvlerësuara në disa nëndisiplina të fizikës; autor monografish dhe tekstesh universitare me të cilat janë formuar e vazhdojnë të formohen brezat e rinj shqiptarë përgjatë afro një gjysmë shekulli; me aktivitete pedagogjike të shtrirë brenda dhe jashtë vendit; personalitet që i kushtoi për afro tri dekada energjitë e tij intelektuale dhe vlerat e veta morale mirëqeverisjes shtetërore, duke kryer detyra dhe funksione shumë të larta në institucione kushtetuese, përfshirë atë të Presidentit të Republikës; i vlerësuar brenda vendit dhe në rrethet politikëbërëse të Perëndimit e të Botës për nisma e vendimmarrje

me rëndësi thelbësore në momente kthesash e tronditjesh sociale, si periudha e ristabilizimit shtetëror pas "krizës së piramidave" dhe Konferenca e Rambujesë; i njohur për maturinë dhe drejtpeshimin në raportet ndërinstitucionale; i cilësuar si personalitet që arriti të rikthejë institucionin e Kryetarit të Shtetit në pozicionin e vet kushtetues dhe që pati e ka ndikim në përpunimin e mendimit kombëtar në shekullin e ri; përfaqësues i Shqipërisë në institucione ndërkombëtare dhe zë i respektuar në mjediset e tyre; me veprimtari botuese të lakmueshme në shkencat e sakta dhe në kahjen politologjike të jetës së tij, bazuar në njohjen teorike dhe përvojën vetjake drejtuese; figurë e dashur dhe e afërt për qytetarët; fitues i nderimeve dhe mirënjohjeve shkencore e qytetare në shumë vende të rajonit dhe Europës; anëtar në akademi shkencash, "doctor honoris causa" dhe "invited professor"; ligjërues e drejtues studimesh pasuniversitare.

Jetë të gjatë akademik Rexhep Meidani, shëndet të mbarë, veprimtari kërkuese e botuese cilësore të mëtejshme.

<https://akad.gov.al/anetare-te-asamblese/>

Disa nga titujt e botimeve të akad. Rexhep Meidanit (të tjerë me ilustrime):

1. "Mbi ndërtimin e botës";
2. "Ndikime filozofike të paradigmës ajnshtajniane";
3. "Fizika moderne" (bashkautor);
4. "Mbi hapësirë-kohën";
5. "A është deterministe teoria kuantike?", bot. ASHSH;
6. "Të vërtetat dhe të fshehtat e entropisë";
7. "Rëniet-ngritjet e demokracisë";
8. "Mbi qeverisjen", I-II;
9. "Beteja për votën";
10. "Kushtetuta: bilanci dhe perspektiva";
11. "Las trampas del Estado-nacion";
12. "Politika in vivo - in vitro";
13. "Kurthet e shtetit-komb";
14. "Kontratë me vetveten";
15. "Politika, morali dhe shteti";
16. "Jus Gentium";
17. Globalizimi, integrimi dhe kombi shqiptar";
18. "Të vërtetat e të fshehtat e entropisë".

Gjuha shqipe është krejt origjinale dhe e dallueshme midis gjuhëve të tjera të familjes që i takon, sepse është monogjuhë: "Nuk kemi gjetur një gjuhë indoeuropiane më të dallueshme se gjuha shqipe"



- "Evolucioni historik i gjuhës shqipe dhe ndryshimet në zhvillimin e saj kanë qenë shumë të shpejta" -

- "Ngjashmëritë midis dy dialekteve të shqipes janë në shkallën për 89.5 për qind", një nivel shumë i lartë konvergjence -

- Paul Heggarty, autor i parë i artikullit të botuar në revistën shkencore me njohje ndërkombëtare "Science", mbajti dje një ligjëratë në kuadër të SNGJLK në Prishtinë; në fillim të nëntorit vjen në Tiranë, me ftesë të Akademisë së Shkencave -

- Një bazë e re të dhënash: pema e familjes së gjuhëve i.e. dhe një hipotezë për origjinën e familjes së gjuhëve indoeuropiane: cili është vendi i shqipes -

- Titulli në anglisht: "A new database, family tree and origins hypothesis for the indo-european language family: what place for Albanian" -

- Paralajmërim i zyrtë: "Brenda disa dekadash gati gjysma e rreth shtatë mijë gjuhëve dhe të folmeve që ekzistojnë në Botë do të shuhen ose do të jenë më pak të kuptueshme" -

Paul Heggarty, autor i parë i artikullit të botuar vjet në qershor në tribunën e mirënjohur "Science" për fillesat prehistorike të gjuhëve idoeuropiane (në këtë kontekst

shqipja merr shumë rëndësi për lashtësinë dhe momentin e parë të shfaqjes "ndryshe" në krahasim me gjuhët më të afërta), ishte një nga ligjëruesit në seminarin e 42-të për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (20 gusht 2024), njoftohet në faqen e posaçme të Seminarit dhe në shtypin e sotëm të Prishtinës.

Heggarty pohoi në ligjëratën e tij se "gjuha shqipe është krejt e dallueshme midis gjuhëve të tjera të familjes që i takon, sepse është monogjuhë" (gjuhë pa lidhje gjenetike motërie apo filiacioni me të tjera, siç përcaktohet në gjuhësinë tradicionale i.e). "Të gjitha këto gjuhë janë pak a shumë të tilla. Por cili është dallimi i saj me trungun e gjuhës shqipe dhe në krahasim me zhvillimet e ngjashme? Metoda jonë këtë synon të zgjidhë. Çfarë rezulton nga kërkimet tona është se "trungu" i gjuhës shqipe ka ndryshuar me shpejtësi. Kjo shpejtësi ndryshimi në gjuhën shqipe është e pazakontë. Kjo rezulton nga burimet që disponon baza jonë e të dhënave "IE-CoP", që është themeluar për marrëdhëniet e gjuhëve indoeuropiane mes tyre, për ngjashmëritë e dallimet dhe lashtësinë e tyre".



Paul Heggarty e ilustroi tezën e tij duke iu referuar projeksioneve në grafikë dhe kronologjizimeve të dukurive në kuadër të zhvillimeve të gjuhëve i.e. dhe origjinës së tyre në momentin e ndarjes nga njëra-tjetra, kur fliteshin përgjatë udhëtimit të tyre nga rajoni i burimit drejt kontinentit tonë, që më pas u indoeuropeizua.

Ai paraqiti fakte interesante në rrafsh të antropogjuhësisë, gjenetogjuhësisë, shqyrtimeve e rishqyrtimeve të historisë së gjuhëve i.e. në prizmin e ADN-së së tyre, para së gjithash për gjuhën shqipe, për ndryshimet që ajo ka pësuar gjatë zhvillimit

(pre)historik të saj; për ngjashmëritë dhe dallimet me gjuhë të tjera indoeuropiane; për rreziqet e zhdukjes si gjuhë që i janë shfaqur.

"Të dhënat për burimin e shqipes dhe historinë e zhvillimit të saj kanë bërë bujë të madhe në qarqet shkencore botërore, tha ai. Kjo sepse gjuha shqipe është gjuha më e veçantë nga të gjithë gjuhët indoeuropiane. Është shumë e rëndësishme për gjuhën shqipe që ajo është shumë e dallueshme. Nuk kemi gjetur një gjuhë indoeuropiane më të dallueshme se ajo. Është shumë origjinale dhe ka një arsye për këtë: sepse ajo ka ndryshuar shumë, ka marrë shumë fjalë nga gjuhët e tjera, duke mbetur gjithnjë origjinale".

Për periudhën "historike" dhe lidhjet e shqipes si pasardhëse e ilirishtes Heggarty tha se, në kuadër të teorisë dhe metodës së tij e të bashkautorëve të artikullit në "Science", kjo është një çështje dytësore, sepse historia e shqipes është më e thellë. "Më e shumta që mund të themi është se gjuhë si shqipja, greqishtja dhe ndonjë tjetër janë gjuhë për të cilat njohim diçka për burimin e tyre, ndërsa ka gjuhë të tjera për të cilat nuk mund të dimë gjë për to, nuk kemi të dhëna. Ka shumë gjuhë dhe varietete të tyre për të cilat nuk dimë saktësisht se nga vijnë. Dimë se me cilën gjuhë shqipja është më e afërt e me cilën më e largët: p.sh., ngjashmëritë me gjuhën angleze dhe nëndegën e saj janë vetëm në nivelin 7.4 për qind".

Në lidhje me lashtësinë "absolute", Heggarty tha se "duhet trajtuar me kujdes", jo në mënyrë popullore dhe politike.

Paralajmërim i fortë i Paul Heggarty-t:

"Ekzistojnë përafërsisht 7 mijë gjuhë në Botë dhe gjysma e tyre do të shuhen brenda disa dekadash ose do të jenë më pak të kuptueshme".

Paul Heggarty ka mbrojtur PhD për gjuhësi krahasimtare në Universitetin e Cambridge-it dhe është "scientific senior" në Institutin "Max Planck" të Gjermanisë. Në biografinë e tij shkruhet se ai ka në fokus "mënyrën se si gjuhët hapin një dritare mbi të kaluarën tonë, në ndërveprim me qasjet nga gjenetika, arkeologjia dhe historia".

"IE-CoR" është themeluar dhe drejtuar nga Paul Heggarty, Cormac Anderson dhe Matthew Scarborough; është licensuar nga

"Creative Commons Attribution 4.0 International License".

Abstrakti anglisht i ligjëratës së Paul Heggarty në linkun në vijim:

<https://www.facebook.com/share/p/VPzbgNgCS6K2sJsu/?mibextid=oFDknk>

Njoftime në disa media të tjera:

<https://gazetadielli.com/nuk-kemi-gjetur-nje-gjuhe.../>

<https://www.koha.net/.../paul-heggarty-gjuha-shqipe-po...>

<https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=673804>

<https://sot.com.al/.../paul-heggarty-gjuha-shqipe-eshte.../>

"Një vështrim krahasimtar letërsisë sociale në Ballkan në periudhën mes dy luftërave", ligjëratë nga Shaban Sinani



- Sot, në ditën e katërt të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, që organizohet në Prishtinë

- Pjesëmarrës në këtë veprimtari: studiues e studentë të interesuar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare; albanologë të huaj e profesorë të Universitetit të Prishtinës

- Gjatë dhjetë ditëve të seminarit paraqiten nëntë ligjëratë për çështje gjuhësore, antropologjike dhe historiografike



Në ditën e katërt të seminarit të 42-të për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, që organizohet prej 50 vjetësh gjatë gushtit nga Universiteti i Prishtinës, me bashkëpunimin e Universitetit të Tiranës, studiuesi Shaban Sinani (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) mbajti ligjëratën “Një vështrim krahasimtar letërsisë sociale në Ballkan në periudhën mes dy luftërave”.

Seanca u drejtua nga prof. dr. Lindita Aliu-Tahiri.

Letërsia sociale në Ballkan në periudhën midis dy luftërave u cilësia nga autori si një zhvillim konvergjent shumëqendror; me karakterin e një nënsistemi letrar në kuadër të zhvillimeve të së njëjtës periudhë në letërsi në Europë e në Lindjen sovjetike.

Paraqitja e krahasuar u bë duke pasur në qendër të këtij nënsistemi letërsinë e Migjenit, vështruar në krahasim me poezinë e bashkëkohësve të tij: Srečko Kosovel (Slloveni), Antun Šimić e Đuro Sudeta (Kroaci dhe Bosnje), Radovan Zogović (Mali i Zi), Kočo Racin (Maqedoni e Veriut), Miloš Crnjanski (Serbi), Hristo Smirnenski (Bullgari); me një ndalesë të posaçme në ngjashmëritë e saj me poezitë e tre vëllimeve me të njëjtin titull ("Pjesme") të kroatit Miroslav Krleža.



Sido që më rrallë e më vonë se në gjuhë e në trashëgiminë e pashkruar, zhvillime të tilla bashkërrjedhëse ka pasur edhe herë tjetër në letërsinë e rajonit (shfaqja e vonuar

e bajronizmit dhe veçmas e romantizmit). Vonesa e studimeve për to lidhet me shumë arsye: interesimi i hershëm i studiuesve të huaj albanologë, helenistë, romanistë e sllavistë për lidhjen gjuhësore ballkanike dhe përgjithësisht për konkordancat midis gjuhëve me kontakt historik apo afëri gjenetike; lindja e gjuhësisë krahasimtare dhe e antropologjisë strukturore; krahas me vetë shfaqjen me vonesë të letërsive kombëtare në Ballkan.

Në këtë ligjëratë u paraqitën argumente të sistemuara për ekzistencën e një rrjedhe të përbashkët panballkanike në zhvillimin e letërsisë në vitet 1920-1930, pavarësisht se në studime ajo është njohur e vazhdon të njihet me emërtime nga më të ndryshmet ("avant-garde", "lost generation", "futurizëm i majtë" / "levnij futurizam"; "late futurism" / "futurizëm i vonë"; "jugofuturizëm", "zenitizëm", "konstruktivizëm/konsi", "krepuskularizëm", "literature of decadence").

Jashtë terminologjisë letrare, për krijimtarinë e të gjithë autorëve që krahasohen në këtë ligjëratë (shqiptarë, malazezë, kroatë, serbë, bosnjakë, maqedonas, bullgarë), janë përdorur emërtimet "letërsi e mjerimit", "letërsi e protestës", "letërsi e zhgënjimit" dhe "letërsi sociale". Nuk kanë munguar emërtime nga më kundërthënëset, që nga "letërsi e dëshpërimit", deri tek "prekursorë e realizmit socialist".

Si dukuri që u zhvillua përmbi kufijtë shtetërorë, në kërkim të së përbashkëtës, në atë shkallë që ekziston, pa krijuar "objekt për objekt", është parapëlqyer emërtimi "letërsi sociale", që njihet edhe në studimet europiane referuar autorëve të tillë si Henri Barbusse, Bertolt Brecht e Louis Aragon në Perëndim dhe V. Majakovski e A. Blok në periudhën e hershme parasovjetike të krijimtarisë së tyre e pak vite më pas.

Ngjashmëritë mes këtyre poetëve bashkëkohës janë të shumë rrafsheve e niveleve, që prej fatit të tyre vetjak (katër prej tyre u ndanë nga jeta fare të rinj, nga e njëjta sëmundje, tuberkulozi); dëshpërimit prej paqes jetëshkurtër të Versajës, që i la të gjithë të pakënaqur, fitues e të mundur; afrimit me idetë revolucionare dhe besimit në një utopi sociale; denoncimit të padrejtësisë; ikjes prej heronjve mitologjikë; kthimit të letërsisë në qytet dhe lartësimit të "karakterëve margjinalë".

Në poetikë të gjithë ishin kundër traditës, kundër rimës, kundër vargut të matur e prozodisë klasike; vargjet e tyre i quanin "kangë" / "pjesme" dhe veten e tyre "këngëtarë"; miti i teknikës dhe vargu i lirë shiheshin si binom; prishja e gramatikës dhe braktisja e shenjave të pikësimit ishte zgjedhje për t'u dalluar prej të tjerëve. U mbështetën në Traktatin futurist të Marinetti-t, që ndryshoi rrjedhat e letërsisë në Europën e shekullit të 20-të.

Në kuadër të megasistemit europian të letërsisë poetët ballkanas të rajonit patën një pozicion të ndërmjetëm, midis "futurizmit zanafillës" të Perëndimit dhe "futurizmit të majtë" të krijimtarisë së hershme të V. Majakovskit dhe A. Blokut në ish-Bashkimin Sovjetik. Nyje ndërlidhëse e këtij "late futurism" që u zhvillua në Ballkan me

modernitetin europian të kohës ishte kroati M. Krleža.

Nga krijimtaria e malazezit Radovan Zogović ishte zgjedhur për krahasim poema "Došljaci - pjesme Ali Binaka" / "Ardhësit, këngët e Ali Binakut); nga slloveni Srečko Kosovel dy vëllimet poetike të tij "Pjesme" dhe "Integrali" - poet i cilësuar si përfaqësues i rrymës "konsi" (shkurtim për "konstruktivist", titull i një reviste letrare në Slloveni); nga kroati Đuro Sudeta, i njohur si "poet i ankthit dhe rrënimit" dhe "që botoi vjersha krepuskulare", u krahasuan vëllimet "Osamljenim stazama" / "Shtigje të vetmuara" dhe "Kućice u dolu" / "Shtëpiza në luginë"); nga serbi Miloš Crnjanski - parathënia e tij për veprën "Sumatra", që u dha karakter programor synimeve estetike dhe qytetare të "zenitistëve" antiperëndimorë, përkundër pjesës tjetër, me mit Europën e qytetëruar.

Një nyje e rëndësishme e nënsistemit të letërsisë sociale në Ballkan, e asaj letërsie që shpesh quhej edhe "e poetëve të zhgënjyer" ("pisateli razočarani"), një term i përdorur më herët nga italianii Sergio Corasini, është kroati Miroslav Krleža, me tre vëllimet e para me poezi dhe me dy poemat e tij "Gospođa u posjeti kod bolesnog djeteta svoje sluškinje" ("Zonja viziton fëmijën e sëmurë të sherbëtores së vet") dhe "Mjerimi me duart e veta të fëlliqura prek çdo gjë", që kanë lënë gjurmën e vet ndikuese në "Poemën e mjerimit" të Migjenit, si në vargëzim, ashtu dhe në frymë. "Poema e mjerimit" është gjithashtu lehtësisht e krahasueshme me "Mbrëmjet dimërore" ("Зимни вечери") të bullgarit Hristo Smirneniski (Христо Смирненски).

Poezia e Migjenit u paraqit në krahasim edhe me veprën e kroatit Đuro Sudeta apo të bosnjakut Antun Simić: bashkëkohës të tij, me të njëjtin fat vetjak, poetë të dëshpërimit, protestës dhe të un-it poetik kolektiv, të identifikimit me fatin e pjesës më të pambrojtur të shoqërisë. Një poet tjetër për të studiuar nënsistemin e letërsisë sociale ballkanase ishte maqedonasi Kosta Racin (Коџо Рацин, Кочо Рацин), që u nda nga jeta i ri në mënyrë të mistreshme, me vëllimin e tij të vetëm poetik "Pesni" (Skopje 1939). Poezitë e hershme të Esad Mekulit (Sad Nokšić) janë të së njëjtës rrjedhë. Mekuli dhe Zogović përdorën forma analitike apoetike të shprehuri, parantezën dhe ndërkaljen brenda vargut; Kosovel futi në poezi formulat teknike dhe e matematizoi vargun, Kosta Racin e kishte të afërt gjuhën shqipe (kishte jetuar afër Strugës) dhe përdori fjalë të bukura të saj në vjershërim ("kulla"); që të gjithë e panë Botën përmes vetes; me përjashtim të zenitistëve të tjerët i njihnin vetes misionë mesianike, prometeike.

Kjo letërsi u zhvillua ku më pak e ku më shumë nën ndikimin e Traktatit futurist të Marinetti-t. Të gjithë kishin mit vargjet e lira, mitin e teknikës dhe refuzimin e "shekullit plak në letërsi".

"Konstruktivistët", "konsi-t", krepuskularistët" sllovenë; "zentististët" serbë, "deziluzionistët" / "razočarani" kroatë, serbë, bosnjakë, bullgarë e maqedonas; pavarësisht nëse i drejtoheshin Nietzsche-s apo Schopenhauer-it; pavarësisht nëse ishin

të dëshpëruar prej fantazmës së fashizmit; pavarësisht ndikimeve prej “brezit të humbur” nga njëra anë dhe të mendimit të majtë europian nga ana tjetër; pavarësisht se shkruan letërsi të angazhuar, bashkohen në qendrimin ndaj shqetësimeve ekzistenciale të shoqërisë në të cilën jetuan. Dallim prej tyre bën traktati i zenitistëve, poetikisht i mbështetur në futurizmin e Marinetti-t, kurse në mendimin politik - në premisën se misioni i Perëndimit kishte përfunduar dhe qytetërimin mund ta shpëtonin vetëm "kulturat barbare".

U theksua se këta autorë ndikohen nga futurizmi dhe njëri-tjetri jo me të dëgjuar, por përmes njohjes dhe leximeve të ndërsjella; rrjedha e letërsisë së tyre ishte kulturë leximesh.

Diskutuan rreth kësaj ligjëratae prof. Isak Shema, akad. Rexhep Ismajli, prof. Aleksandër Novik, prof. Muhamet Hamiti, dr. Nathalie Clayer dhe të tjerë.

Gjatë 10 ditëve të seminarit (20-30 gusht) në program janë këto ligjërata:

Paul Heggarty: “A new database, family tree and origins hypothesis for the indo-european language family - what place for Albanian”;

Yll Rugova (Belgjikë): “Alfabeti më i vjetër origjinal i shqipes në dritën e një burimi të ri”;

Shaban Sinani (Shqipëri): “Një vështrim krahasimtar letërsisë sociale në Ballkan në periudhën mes dy luftërave”;

Oliver Jens Schmitt (Austri): “Prishtina and Kosova in the late Ottoman period - the view of Austro-Hungarian diplomats”;

Jose M. Floristan (Spanjë): “The Albanian communities of Naples and Sicily (16th and 17th c.) between the Balkan revolt and the service to the Spanish crown”;

Ranko Matasović (Kroaci): “Latin loanwords in Albanian: problems of relative chronology”;

Francesco Altimari (Itali): “Realizime dhe projekte të katedrës së shqipes të Universitetit të Kalabrisë në shërbim të albanologjisë dhe komunitetit arbëresh”;

Rexhep Ismajli (Kosovë): “Studimet e shqipes në ish-Jugosllavi”;

Phil Hubbard (Amerikë): “Memories of the 1977 seminar: how it influenced my life’s path”.

<https://www.facebook.com/share/p/h8FbBY2pVEoeJ6qx/?mibextid=oFDknk>

<https://www.forum-al.com/.../seminari-i-50-t%C3%AB-nd%C3.../>

<https://www.koha.net/.../seminari-ne-gjysmeshekull...>

Dorëshkrimet e shkrimtarit Ismail Kadare do të ruhen në një mjedis të veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA)



Familjarët e shkrimtarit të madh kanë dorëzuar për ruajtje, administrim, restaurim dhe digitalizim në DPA gjithë koleksionin letrar të Ismail Kadaresë, duke përfshirë dorëshkrime, skicë-ide veprash, vepra të pabotuara në dorëshkrim, si dhe drafte fillestare të punimeve të tij; dokumente që do të mbeten përjetë, tha drejtori i përgjithshëm i arkivave Ardit Bido. Kjo ka një rëndësi madhore kur vjen fjala për figura që jetojnë përjetë, sa ekziston memoria kolektive kombëtare.

Nga ana e saj Gresa Kadare, e bija e shkrimtarit, foli mbi arsyet që e shtynë drejt vendimit për të dorëzuar pranë DPA-së arkivin e tij, duke shtuar se më herët interes për këtë arkiv ka pasur nga institucione të huaja:

“Desha t’ju falënderoj juve personalisht për mirëkuptimin që gjetëm dhe mirëbesimin reciprok, sepse nuk është gjë e lehtë të marrësh një iniciativë të tillë. Ismailit në Paris para disa viteve i janë ofruar plot institucione të huaja, qofshin franceze si Universiteti i Sorbonës, Akademia e Francës, Biblioteka “François Miterrand”. Ata donin të merrnin plotësisht ose pjesërisht, një pjesë të arkivave, sigurisht me pëlqimin e tij. Erdhi edhe një propozim shumë interesant nga Universiteti Princeton në Nju-Jork”, tha ajo.

Gresa Kadare kujton se shkrimtari hezitonte, ishte në mëdyshje dhe diçka e pengonte:


“Nuk ka dhënë një përgjigje të qartë. I thashë në diskutim mes nesh: Po si e ke menduar, çfarë do tamam të bëhet me arkivën tënde, pse nuk shprehesh dhe pse nuk merr një vendim, se për arsye të ndryshme humbasin gjërat? ‘Nuk di se çfarë dua të bëj, sepse unë dua që arkivi të kthehet në Shqipëri, por nuk di cilit institucion t’ia besoj’. Dhe kjo ngeli kështu. Ai nuk dha përgjigje të prerë, por unë me iniciativën time vendosa t’ia plotësoj këtë amanet duke ju dhënë juve besimin total”, tha vajza e shkrimtarit. Ajo theksoi se është shumë e vështirë t’i besohen, qoftë dhe një institucioni serioz, gjëra kaq të vyera.



“Unë jam shumë e prekur personalisht kur pashë se Kodikët e Beratit prehen këtu gjithashtu. Më emocionon ideja që dorëshkrimet e Ismailit do të jenë në shoqëri të mirë pranë Kodikëve të Beratit e në njëfarë mënyre, ndoshta e ekzagjeroj, por më duket sikur janë këto kolonat e një tempulli tonë të përbashkët, që është trashëgimia kulturore shqiptare, që duhet ruajtur. Dhe jo vetëm ruajtur si një qenie e balsamosur. Unë shpresoj që në një kohë të dytë, Arkivi do të lejojë aksesin e studiuesve, kritikëve letrarë, studentëve, të vijnë ta konsultojnë, ta studiojnë dhe ta mbajnë gjallë arkivin”, theksoi Gresa Kadare.

Mes materialeve të dorëzuara, bëjnë pjesë dorëshkrimet e veprave: “Spiritus”,


“Darka e gabuar”, “Ra ky mort e u pamë”, “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, “Koha e parasë”, “Historia e Lidhjes së Shkrimtarëve”, “Stinë e mërzitshme në Olimp”, “Hamleti”, “Hijet”, “Përbindëshi” dhe “Mosmarrëveshja”. Po ashtu, janë dorëzuar edhe shtypshkrimet e veprave “Sorkadhet e trembura”, “Aksidenti”, “Ftesë në studio”, “Ëndërrimet” dhe “Mëngjese në Kafe Rostand”. Krahas tyre, gjenden edhe blloqet me shënime të hedhura prej Kadaresë gjatë krijimtarisë, albume me foto të tij familjare, albume nga aktivitete të shumta kulturore, si edhe dekreti i shtetësisë së Republikës së Kosovës.



<https://ata.gov.al/.../doreshkrimet-e-kadarese.../>
<https://top-channel.tv/.../veprimtaria-letrare-e-ismail.../>
<https://euronews.al/rama-veprat-dhe-doreshkrimeve-e.../>
<https://eunews.al/doreshkrimet-e-kadarese-dorezohen-ne-dpa/>
<https://albanian.cri.cn/.../ARTI9zvhmYjpYsGAUnn4vV8s24082...>
<https://abnase.com/kadares-manuscripts-are-handed-over.../>
<https://abcnews.al/veprimtaria-letrare-e-ismail-kadarese.../>
<https://klankosova.tv/pasuria-e-kadarese-kthehet-ne.../>
<https://alsat.mk/doreshkrimet-e-kadarese-dorezohen-ne-dpa/>
<https://www.panorama.com.al/doreshkrimet-e-ismail.../>
https://www.instagram.com/ediramaal/reel/C_AwzCyIyCc/
<https://fax.al/.../doreshkrimet-e-kadarese-pavijon-i...>
<https://alb-spirit.com/.../doreshkrimet-e-ismail.../>

<https://prizrenpress.com/doreshkrimet-e-kadarese.../>
<https://youtu.be/mhSC5MOB4DA>
[https://www.balkanweb.com/fondi-i-vyer-i-veprimtarise.../...](https://www.balkanweb.com/fondi-i-vyer-i-veprimtarise.../)
<https://shqiptarja.com/.../arkivi-im-dua-te-kthehet-ne...>
<https://www.report-tv.al/.../arkivi-im-dua-te-kthehet-ne...>
<https://www.dukagjini.com/doreshkrimet-e-kadarese.../>
<https://newsbomb.al/.../arkivi-im-dua-te-kthehet-ne...>
<https://pafrike.al/doreshkrimet-e-ismail-kadarese.../>
<https://www.007vox.com/.../familja-kadare-i-dhuroi...>
<https://www.kultplus.com/tag/ismail-kadare/>

Matteo Mandalà dhe Lea Ypi, anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave, referues për diplomacinë kulturore në konferencën "Diplo 2024" organizuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme



Në ditën e dytë të konferencës së ambasadorëve dhe konsujve të Shqipërisë në botë “Diplo 2024” ishin të ftuar dhe referuan për çështje të diplomacisë kulturore anëtarët e jashtëm të Akademisë së Shkencave profesorët Matteo Mandalà dhe Lea Ypi.

Konferenca është vlerësuar si një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit dhe me pritshmëri nxitëse, sepse gjatë katër ditëve të punimeve të saj (25-28 gusht) u mundëson diplomatëve të Shqipërisë, ambasadorë e konsuj, diskutimin për çështje të prioriteteve të vendit dhe të qendrimeve ndaj problematikave më të mprehta të kohës.



Takimi i diplomatëve është i përvitshëm dhe zhvillohet me synimin për të sinkronizuar nismën dhe ndërveprimin e rrjetit dinamik të diplomacisë dhe për të përditësuar vazhdimisht funksionimin e tij për të gjitha temat që kanë të bëjnë me eurointegrimin dhe me çështje globale, si siguria kibernetike, turizmi, ekonomia dhe kultura.




Ndër çështjet kulturore, në konferencë zë vendin kryesor tema “Si mund të ndihmojë diplomacia kulturore në formimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe?”. Për këtë prioritet folën anëtarët e jashtëm të Akademisë së Shkencave Matteo Mandalà e Lea Ypi.

Prej disa vitesh diplomacia kulturore është dëshmuar e sukseshme për të përmirësuar imazhin e vendit, duke krijuar sinergji të sukseshme midis intelektualëve të rrjetit kombëtar të kërkimit shkencor dhe diasporës intelektuale.

<https://www.visitpiana.com/post/il-professore-matteo-mandalà-relatore-alla-conferenza-degli-ambasciatori-della-repubblica-di-albania>

Botime të reja

Albert Nikolla boton librin "Antikultura" e 1968-ës në Shqipëri"



Albert Nikolla boton librin "Antikultura" e 1968-ës në Shqipëri", një monografi kushtuar zhvillimeve në Shqipëri në periudhën e revoltave masive të rinisë dhe studentëve në Europë e në shkallë globale, në kontekst të tyre, prej "lëvizjeve revolucionarizuese" të nxitura e udhëhequra nga leadership-i politik i kohës deri tek "dalja duarsh" në periudhën e shkurtër liberale.

Albert Nikolla është profesor i asociuar, është drejtues i redaksisë për religjionet në "Enciklopedinë shqiptare", me të cilën libri i posabotuar ka lidhje përmbajtësore.

Libri shoqërohet me një shenjim hyrës nga Shaban Sinani.

Nga parathënia:

Libri i Albert Nikollës shpjegon për herë të parë që Brezi 1968, me pamjen e vet sa të vrazhdë aq dhe shkundulluese për rendin e mëparshëm, nuk ishte një zhvillim ishullor; një vullkan që u ndez e u shua kur deshi leadership-i politik; por pjesë e historisë europiane e botërore të atij përshtjellimi që ndodhi në atë vit, me shpërthimin e lëvizjeve dhe rebelimeve anarkiste, majtiste, që vunë në provë për herë të parë rendin botëror të vendosur pas fitores së antifashizmit, eficiencën e republikanizmit dhe të demokracisë së gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Status quo-ja u prish: rinia dhe studentët e refuzuan edukimin skolast dhe doktrinar (We dont need no education); më në Perëndim, në SHBA, u refuzua vendosmërisht paraqitja e luftës në Vietnam si çështje patriotike dhe heroizmi (The unfortunate soldier). Në Europën e Lindjes mori fund madhështimi i sovjetizimit. Më në Lindje ende, në Kinën e vitit 1968, në epokën e dacibao-ve, qindra milionë qytetarë, shtetas të bindur e të pabindur, u ngritën në një lëvizje popullore me karakter skajshmërisht të majtë.

Me studimin e tij monografik Albert Nikolla ia ka dalë të provojë se, në këtë kontekst, Shqipëria nuk kishte nga ia mbante, do të përfshihej objektivisht në epokën e ndryshimit. Tirana, shtypi i saj, brohoriste çdo ditë për lëvizjet e mëdha studentore (më pas dhe të punëtorisë) në Europë, nga njëra anë; ribotonte artikujt e Zhenminzhibao-s për revolucionin kulturor nga ana tjetër dhe, po në atë kohë, merrte vendimin historik për të dalë nga Traktati i Varshavës dhe për të mbështetur popullin e Çekosllovakisë në qendresën e vet, qoftë dhe në formën e protestës pasive si vetëdjegia heroike e të riut Jan Palach në një shesh të Pragës.

Parathënia e plotë në linkun në vijim:

<https://metropolpost.al/antikultura-e-1968-es-ne.../...>

"Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon"

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHQËRORË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

SFIDAT DHE PERSPEKTIVA E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK KOSOVË-SHQIPËRI DHE RAJON

CHALLENGES AND PERSPECTIVE OF ECONOMIC COOPERATION OF KOSOVA- ALBANIA AND THE REGION

Konferencë shkencore ndërkombëtare
International Scientific Conference

6-7 tetor / October 2023




"Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon" - botohen në Prishtinë aktet e konferencës me të njëjtin titull organizuar më 6-7 tetor 2023 nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë e të huaj nga fushat e ekonomisë, financës, bankingut, tregtisë, mirëqeverisjes, politikave të zhvillimit, çështjeve gjeorajonale dhe të marrëdhënieve ndërshtetërore.

ASHAK dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë janë bashkëbotues të vëllimit.

In memoriam

Gjergj Gjura, një nga përfaqësuesit e brezit të parë të ekspertëve shqiptarë të matematikës së zbatuar, është ndarë nga jeta



Gjergj Gjura i takon brezit të themeluesve të Qendrës së Matematikës Llogaritëse, e njohur më vonë me shkurtesën INIMA ose Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar.

Iu përkushtua studimit të thelluar e kualifikimit të vazdueshëm bashkë me kolegët e tij, të cilët vendosën themelet akademike e shkencore në sektorët e informatikës, të kërkimeve operationale, të statistikës matematike, të teknikës llogaritëse elektronike, të metodave të përgjithshme llogaritëse e të shërbimit masiv.

Brezit i parë i specialistëve të matematikës, informatikës, inxhinierisë elektronike etj., të cilit i përkiste Gjergji, realizoi këtë projekt të madh me shtrirje në dy fusha të ndryshme, por të pandashme, si matematika e aplikuar dhe informatika. Ai brez zgjidhi paralelisht një varg problemesh në ekonominë shqiptare, si energjetikë, statistikë, demografi, gjeologji, gjeofizikë, metalurgji etj.

Pas disa specializimeve, jashtë vendit, kryesisht në Francë, si ngriti dukshëm nivelin e tij shkencor në fushën e kërkimit e të zbatimit të metodave matematikore në degë të ndryshme të ekonomisë shqiptare. Krahas punës në këtë institucion ai mbajti

lëndën e specialitetit në UT. Ishte nga të parët me doktoraturë të mbrojtur në fushën e zbatimeve të matematikës e fizikës.

Për punë të çmuar në informatizimin e institucioneve qeveritare ai u nderua me Çmimin e Republikës.

Dekadat e fundme i kaloi në SHBA, (Massachusetts), ku vijoi veprimtarinë universitare në “Quincy College” dhe fitoi titullin "profesor emeritus" në departamentin e shkencave kompjuterike.

Gjergj Gjura ka merituar dhe meriton nderimin e shkencës shqiptare.

<https://gazetadielli.com/lamtumire-profesor-emeritus.../>

Sot ditëlindja e bashkëthemeluesit të Akademisë së Shkencave, ikonës së saj të djeshme e të sotme, historianit të gjuhës, letërsisë dhe trashëgimisë gojore, prof. Eqrem Çabej.



Eqrem Çabej është referenca më e rëndësishme shkencore shqiptare e albanologjisë kudo që zhvillohet në Botë.

Tezat themelore të albanologjisë si dije me objekt e metodë shkencore, me paradigmë objektive, janë të lidhura me emrin dhe veprën e tij.

Studimet etimologjike, të historisë së gjuhës së folur e të shkruar, të periudhës hipotetike dhe të asaj historike të saj, qendrojnë në themel të studimeve shqiptare në përgjithësi.


Kontributet e Eqrem Çabejt për periudhizimin e historisë shqipe; për historinë e zhvillimit të saj që nga libri i parë, "Meshari" i Gjon Buzukut, deri tek autorët më të rëndësishëm të periudhës midis dy luftërave, si Fishta e Poradeci; janë themelvënëse për zhvillimin e saj si shkencë.

Trashëgimia origjinale e italo-shqiptarëve; mitologjia, tabutë dhe totemet, eufemizmat; shtresat më të lashta të saj, u trajtuan mjeshtërisht prej tij në rrafsh antropologjik e gjuhësor, mitologjik e folkloristik.

Eqrem Çabej pati autoritetin vetjak që të zbatonte në kërkimet e tij një metodë ideologjike e zyrtarisht të qortuar e të refuzuar, si "shkolla e fjalëve dhe sendeve", duke e shpallur hapur si zgjedhje.

Ndiqni në linkun më poshtë fjalën e prof. Eqrem Çabejt në mbledhjen themeluese të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Dhjetë vjet nga ndarja nga jeta, nderim akad. Shaban Demirajt



Dhjetë vjet më parë u nda nga jeta akad. Shaban Demiraj, përfaqësues i shkencës së albanologjisë shqiptare përgjatë një gjysmë shekulli dhe urë ndërlidhëse midis breznive të saj; studiues i gjuhës shqipe në të gjitha rendet e saj (fonetikë, morfologji, sintaksë); historian i shqipes së folur e të shkruar, i ligjësive të zhvillimit të saj nga burimi në kohët moderne dhe i zhvillimit bashkëkohor të saj; i dialekteve dhe shqipes së njësuar; në rrafsh të brendshëm e të jashtëm (në kuadër të familjes indoeuropiane, të burimit gjenetik dhe lidhjeve e afërive për shkaqe të kontaktit historik, sidomos në lidhjen gjuhësore ballkanike); bashkautor i veprës madhore "Gramatika e shqipes", e

njohur si "Gramatika e Akademisë"; titullar i lëndës së fonetikës dhe morfologjisë historike në UT dhe hartues i tekstit të saj; editor, përkujdesës e përshtatës i një numri veprash të shkrimtarëve arbëreshë për lexuesin e sotëm; mentor studimesh gjuhësore të shkallës së doktoratës brenda e jashtë vendit e përkthyes; me rol të rëndësishëm për kodifikimin e shqipës së njësuar dhe zhvillimin e natyrshëm të saj si gjuhë letërsie, kulture e qytetërimi krahas me pasurimin e saj prej të folmeve e stileve të ligjërit; kryetar i Akademisë së Shkencave në një periudhë të ndërlikuar ndryshimesh në vitet 1990.

Nderime veprës dhe emrit të tij.

Në vijim bibliografia e plotë e akad. Shaban Demirajt hartuar nga biblioteka shkencore e Akademisë sipas programit ndërkombëtar Cobiss.al:

https://bib.cobiss.net/.../bib201_20240830_192014_00751.html


Në media:

<https://www.facebook.com/share/p/ZV1yVDiCxRX4HjXc/?mibextid=oFDknk>

www.akad.gov.al

Homazh për Luan Starovën, shkrimtar i tri gjuhëve, në televizionin francez "Arte"

- Figura e akademikut Luan Starova, çelës për të kuptuar rajonin, historinë dhe trashëgiminë e tij



“Invitation au voyage” (“Ftesë për udhëtim”), një emision i televizionit të njohur francez për kulturë “Arte”, që paraqet vende të ndryshme në botë përmes një personazhi të shquar, kësaj radhe zgjodhi për të paraqitur Shkupin dhe liqenin e Ohrit, përmes veprës dhe personalitetit të shkrimtarit Luan Starova.

Siç shprehet moderatorja në fillim, është historia e një liqeni dhe ajo e një njeriu: liqeni i Ohrit, më i vjetri në Europë dhe një njeriu - Luan Starova. Ai ka lindur në një rënë anë të liqenit, në Shqipëri dhe ka jetuar në anën tjetër, në Maqedoni. Një histori mërgimi dhe urash mes popujve; një “Sagë ballkanike” që Luan Starova e ndërtoi për mbi tri dekada krijimtari letrare, e përkthyer në më shumë se njëzet gjuhë.

I shpërngulur, emigrant, shkrimtar-ëndërrimtar i përhumbur në Ballkan. Kështu cilësohet Luan Starova nga Arian Leka, shkrimtar, poet dhe studiues:

Një europiani leximi i Luan Starovës i mundëson ta kuptojë më mirë Ballkanin. Për një ballkanas, qoftë ai shqiptar, maqedonas, boshnjak apo serb, leximi i Luan Starovës është çelës për të kapërcyer dhe tejkaluar stereotipat, për të madhëruar vlerat që na bashkojnë dhe për të kuptuar gjithçka që ne mund t'i ofrojmë Europës.

Ai vetë është njeriu-kufi, që luftoi për të kapërcyer kufijtë. Ai është njeriu-emigrant, që ka pranuar përndjekjen, i cili është pajtuar me dy gjendjet e tij të brendshme, atë të vendasit dhe atë të huajit. Ai gjithmonë përpiquej, thellë brenda vetes, të ishte dhe të kuptonte "tjetrin".



Si njeri, unë e krahasoj Luan Starovën me këtë liqen. Rrymat që e lëvizin janë të brendshme, të fshehura në sipërfaqen e qetë, kështu që ne nuk mund ta kundrojmë dhe ta kapim zemërimin e tij, ndërkaq ai vetë, bën gjithçka për t'i mbajtur nën kontroll plagët e tij të brendshme. Por si shkrimtar Luan Starovën e konsideroj si këtë lumë, që gufon me gjithë fuqinë e tij, duke krijuar një letërsi të madhe, të jashtëzakonshme, që buron prej këtu dhe që derdhet në të gjitha gjuhët e kontinentit.

Vlada Urošević, shkrimtar, shprehet:

Në romanet e tij, Luani gjurmon origjinën e familjes së tij. Forca e porosisë së tij është se, pavarësisht gjitha shkatërtimeve, luftërave, periudhave të rrënimit, ka edhe gjëra të bukura që ndodhin dhe mbijetojnë. Këto janë librat.

Luan Starova jetonte në një shtëpi, disa hapa larg nga këtu, nga lumi Vardar. Ai ecte çdo ditë përgjatë këtyre brigjeve. Për të, lumi Vardar nuk paraqiste vijë ndarëse. Përkundrazi, ai ishte një forcë që bashkon dy brigjet dhe që lidh, në mënyrë simbolike, kombet që jetojnë në Maqedoni.

Shenjimi i shkurtër i "Arte TV" për emisionin:

C'est l'histoire d'un lac et celle d'un homme. Le lac Ohrid, le plus vieux

d'Europe, et l'homme, Luan Starova. Ce dernier est né d'un côté du lac, en Albanie, et il a vécu de l'autre, en Macédoine du Nord. Une histoire d'exil et de ponts entre les peuples. Une Saga Balkanique que Luan Starova a bâtie en trois décennies d'écriture, traduite en plus de vingt langues.

Emisioni i plotë në:

<https://www.arte.tv/.../en-macedoine-du-nord-un-ecrivain.../>

<https://zhurnal.mk/televizioni-i-njohur-francez-tv-arte.../>

<https://www.slobodenpecat.mk/.../poznatata-francuska.../>

<https://plusinfo.mk/prikazna-za-ohridskoto-ezero-i-za.../>

<https://republika.mk/.../poznatata-frantsuska-televizija.../>

<https://time.mk/.../poznatata-francuska-televizija-arte.../>

Nekrologji

Ndahet nga jeta studiuesi i njohur Mevlan Kabo



Akademia e Shkencave njofton me hidhërim ndarjen nga jeta të studiuesit Mevlan Kabo, një prej bashkëpunëtorëve të hershëm e të përhershëm të saj dhe u shpreh ngushëllimet e veta bashkësisë së studiuesve të gjeografisë, kolegëve e miqve të tij të shumtë, familjes së tij të shtrenjtë.

Prof. Mevlan Kabo është një ndër përfaqësuesit e denjë të plejadës së gjeografëve që hodhën bazat e arsimit dhe të shkencës gjeografike shqiptare. Kolegët e tij, gjeografët, disa breza mësuesish e studentësh, do t'i jenë gjithnjë mirënjohës.

Kontributi i prof. Mevlan Kabos u shtri në shumë fusha: pedagogjike, shkencore, drejtuese dhe publicistike. Ai ishte drejtues i suksesshëm sektori në Insitutin e Studimeve e Botimeve Shkollore dhe Enciklopedike; drejtues i insitucioneve universitare (pedagog i gjeografisë dhe përgjegjës i katedrës së gjeografisë, zëvendësdekan i Fakultetit të Historisë e Filologjisë në Universitetin të Tiranës); drejtues i insitucioneve shkencore (drejtor i Qendrës së Studimeve Gjeografike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; kryeredaktor dhe bashkautor i veprës monumentale kombëtare "Gjeografia fizike e Shqipërisë" (botim i Akademisë së

Shkencave, 1991); drejtues e redaktor shkencor i fushës së gjeografisë për "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar" (1985 dhe 2008).

Kontributi pedagogjik dhe shkencor i prof. Mevlan Kabos u shtri edhe në Kosovë, ku vendosi themelet e bashkëpunimit shkencor me Universitetin e Prishtinës. Kudo ku ka punuar prof. Kabo u dallua për korrektesë, drejtësi, aftësi drejtuese, mendim novator dhe kulturë të gjerë shkencore gjeografike.

Profesor Kabo është autor dhe bashkëautor në vepra të mëdha kombëtare, monografi, studime, artikuj studimorë, referime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, harta, libra shkollorë për arsimin parauniversitar dhe universitar etj. Me formimin solid gjeografik dhe informacionin e gjerë dhe shumë të pasura gjeografik ai ishte një enciklopedi për gjeografinë e Shqipërisë.

Familja humbi njeriun e dashur, arsimit dhe shkencë gjeografike shqiptare humbën pedagogun e talentuar, studiuesin dhe themeluesin e studimeve gjeografike shqiptare. Ngushëllimet tona shkojnë për ta.

Lamtumirë profesor Kabo!

U nda nga jeta "mbrojtësi i gjuhës së etërve", hartuesi i ligjit për statusin juridik të gjuhëve të pakicave në Itali, propozuesi e realizuesi i njohjes ligjore të arbërishtes si gjuhë mësimi në shkollë, on. Mario Brunetti

il giornale dei giornalisti dal 1997
Corso del Rinascimento, 1 - Tel. 06 686 1293

Calabria > Addio Mario Brunetti, difensore della lingua dei padri

Comunista, meridionalista, signore del giornalismo e della politica. Cordoglio Figec Cital

Addio Mario Brunetti, difensore della lingua dei padri

Pino Nano 12 Agosto 2024

Calabria, Costume & Società, Cultura, I nostri lutti, Leggi & regolamenti, Sindacato, Vite da Oscar



Mario Brunetti

Lajmin e hidhur për largimin pa kthim të on. Mario Brunetti-t e bëri të ditur revista "Giornalistitalia", që i kushtoi personalitetit të tij një artikull të gjatë, duke u ndalur në veprimtarinë e tij mbi 70-vjeçare si jurist, publicist, politikan e veprimtar i shquar i së majtës tradicionale e moderne italiane, deputet, autor i shumë librave studimorë, kulturorë e letrarë.

Mario Brunetti mori pjesë aktivisht në luftë si antifashist dhe ishte një prej përfaqësuesve të shquar të antifashizmit italian; mik i veçantë i Shqipërisë në të dyja periudhat e historisë moderne të saj. Është nderuar me mirënjohje të larta nga shteti shqiptar para së gjithash për rolin e tij si protagonist i njohjes së statusit ligjor të arbërishtes në Itali. Nuk ishte arbëresh nga origjina, por "u bë më arbëresh se ne", do të thuhej për të.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka pasur nderin dhe kënaqësinë ta ftojë e ta mikpresë on. Mario Brunetti-n si ligjërues e referues në konferenca shkencore edhe vitet e fundme, duke përfshirë atë të 75-vjetorit të çlirimit përkujtuar më 2019.

Megjithëse rreth 90 vjeç, Mario Brunetti ndërmori nismën për nderimin e figurës tjetër të rëndësishme të botës italo-shqiptare Antonio Gramshi, veprimtar antifashist me njohje europiane, teoricien, estet, krenar për origjinën e tij shqiptare. Në kuadër të nismës "Itinerari gramsciani", themeluar prej tij, Akademia e Shkencave bashkëpunoi ndër vite, në Shqipëri e ndër komunitetet arbëreshe, me on. Mario Brunetti-n. Ai ishte rregullisht i pranishëm aktiv në veprimtaritë e organizuara nga dijetarët arbëreshë që drejtonin e drejtojnë katedrat e shqipes në Cosenza e Palermo, akademikët Francesco Altimari e Matteo Mandalà.

Disa nga veprat e Mario Brunetti-t janë:

1. "Diritto a la tutela delle minoranze linguistiche regionali";
2. "Legge regionale";
3. "Salvaguardia della minoranza arbëreshë";
4. "Imparare l'albanese - mësoj gjuhën shqipe";
5. "Vecchie e nuove minoranze culturali: definizione di una mappa della presenza";
6. "Antonio Gramsci: l'uomo, la favola";
7. "La piazza della rivolta";
8. "L'attualità inattuale";
9. "La sinistra perduta";
10. "Ieri e domani".

Kryesia e Akademisë së Shkencave shpreh dhimbjen e saj për këtë humbje të madhe dhe u përcjell ngushëllimet e veta familjarëve e të afërmve, studiuesve të botës arbëreshe e mbrojtësve të gjuhës dhe trashëgimisë arbërore në Itali, kolegëve tanë akademikë që e kishin nyje të fortë ndërveprimi.

Artikulli i plotë kushtuar Mario Brunetti-t në "Gornalistitalia" gjendet në linkun në vijim.

<https://www.giornalistitalia.it/addio-mario-brunetti.../>

<https://www.rainews.it/.../e-morto-mario-brunetti...>

Në shtyp gjithashtu:

<https://americaneye.al/ndahet-nga-jeta-mario-brunetti.../>
<https://americaneye.al/arberesh-si-ai/?sfnsn=wa>
<https://frekuenca.net/.../35692-ndarja-nga-jeta-e-mario...>
<https://www.calabriadirettanews.com/.../calabria-in.../>
<https://www.nuovacosenza.com/.../ago/12/mortobrunetti.html>
<https://www.google.com/.../politica-calabrese-in.../amp/>
<https://www.corrieredellacalabria.it/.../morto-a-cosenza.../>
<https://www.lametino.it/.../e-morto-il-giornalista...>
<https://www.google.com/.../morte-di-mario-brunetti.../%3famp>
<https://ilmanifesto.it/mario-brunetti-comunista-e...>
<https://www.google.com/.../ndarja-nga-jeta-e-mario.../>